



المؤسسة الإسلامية للشباب

Fondazioni i Rinisë Islame
Stiftung der Islamischen Jugend
Foundation of Islamic Youth

Seebacherstrasse 67
CH-8052 Zürich
☎ + 41 (0) 43 300 16 70

www.islamischen.ch
✉ Islamischen@freesurf.ch
info@islamischen.ch

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

N ë emër të A ll-llahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshiruesit!

PARIMET ISLAME

Mevdudi

Botuar nga: SHB Logos-A

Të gjitha të drejtat e këtij libri i takojnë botuesit

Ç'DUHET DITUR NË THELB PËR TË QENË MUSLIMAN?	6
DHURATA MË E MADHE E ALL-LLAHUT XH.SH.....	6
VËLLEZËR MUSLIMANË!.....	6
OBLIGIM PËR SHKAK TË DHURATËS	6
HAPI I PARË PËR T'U BËRË MUSLIMAN	7
EMËRTIMI "MUSLIMAN" A KA KUPTIMIN E PREJARDHJES?.....	7
KUPTIMI I PRANIMIT TË ISLAMIT	9
KËRKESA E PARË – DITURIA.....	9
RËNDËSIA E DITURISË.....	11
DALLIMI I VËRTETË NDËRMJET MUSLIMANIT DHE KAFIRIT	12
PSE KA DALLIM NDËRMJET MUSLIMANIT DHE KAFIRIT?	12
VËLLEZËR MUSLIMANË!.....	12
VALLË MOS ËSHTË DALLIMI VETËM NË EMËR?	13
DALLIMI I VËRTETË - ISLAMI DHE KUFRI	14
SHKAKU I DALLIMIT - DITURIA DHE VEPRA	14
PËRSE MUSLIMANËT SOT JANË TË POSHTËRUAR?.....	16
LËNDË PËR SHQYRTIM SERIOZ.....	19
DËSHIRA PËR TË FITUAR DITURI	20
FAKTE PËR PËRSIATJE TË THELLA	21
QËNDRIMI YNË NDAJ KUR'ANIT A.SH.....	21

ME RËNDËSI ËSHTË QË TË KUPTOHET DHE TË PASOHEK KUR'ANI A.SH.....	23
PASOJAT E PADREJTËSISË NDAJ LIBRIT TË ALL-LLAHUT XH.SH.....	24
KUSH QUHET MUSLIMAN?.....	26
KUPTIMI I ISLAMIT.....	26
DETYRA E MUSLIMANIT.....	27
KUPTIMI I FJALËS SË MIRË (KELIME TAJJIBE-S).....	29
VËLLEZËR MUSLIMANË!.....	29
PËRSE DALLIM KAQ I MADH?	30
KUPTIMI I KELIMES.....	32
MARRËVESHJE ME ALL-LLAHUN XH.SH.....	33
PRANIMI I UDHËHEQJES SË PEJGAMBERIT A.S.....	34
PËRGJEGJËSITË QË BUROJNË NGA DËSHMIA.....	35
ME PRANIMIN E ISLAMIT NUK I BËHET SHËRBIM ALL-LLAHUT XH.SH.....	37
DHURATA E ALL-LLAHUT XH.SH. DHE SJELLJA JONË.....	37
FJALA E MIRË DHE FJALA E KEQE (KELIME TAJJIBE DHE KELIME HABITHE).....	38
VËLLEZËR MUSLIMANË!.....	38
Ç'ËSHTË KELIMEJA TAJJIBE (FJALA E MIRË)?.....	41
Ç'ËSHTË KELIMEJA HABITHE (FJALA E KEQE)?.....	42
DALLIMI NË REZULTAT.....	43
PËRSE JANË NË FATKEQËSI PËRULËSIT E KELIMES?.....	44

A KORRIN SUKSES BESIMTARËT E KELIMES HABITHE?	46
QËLLIMI I DEKLARIMIT TË BESIMIT NË KELIMEN TAJJIBE	47
VËLLEZËR MUSLIMANË!	47
ÇDO VEPËR KA QËLLIM	47
QËLLIMI I SHPREHJES SË KELIMES	48
MOSSUKSESI DHE SUKSESI NË BOTËN E ARDHSHME	49
PËRSE EKZISTON DALLIMI NË PASOJAT NDËRMJET KAFIRIT DHE MUSLIMANIT?	50
QËLLIMI I KELIMES- REFORMË E DITURISË DHE VEPRËS	51
ÇKA MËSON KELIMEJA TAJJIBE?	52
VEPRAT MEDOEMOS DUHET TË JENË NË PAJTIM ME DITURINË	53
EBU'L-A'LA EL-MEWDUDI (1903-1979),	54

Ç'DUHET DITUR NË THELB PËR TË QENË MUSLIMAN? DHURATA MË E MADHE E ALL-LLAHUT XH.SH. VËLLEZËR MUSLIMANË!

Çdo musliman sinqerisht beson se Islami është dhurata më e madhe e All-llahut xh.sh., në këtë botë. Ai ndjen falënderim dhe lavdërim ndaj All-llahut xh.sh, për atë që e bëri nga ummeti i Muhammedit a.s., dhe që i dhuroi bekimin e fesë Islame. Vetë All-llahu xh.sh. këtë dhuratë e konsideron më të madhen që ua ka dhuruar atyre që e adhurojnë dhe e respektojnë, siç është cekur në Kur'an: “Sot përsosa për ju fenë tuaj, plotësova ndaj jush dhuntinë Time, zgjedha për ju Islamin fe”. (Kur’ani; 5:3)

OBLIGIM PËR SHKAK TË DHURATËS

Jemi të detyruar t’ia kthejmë All-llahut xh.sh. atë që I takon, për shkak të dhuratës, të cilën na e ka dhuruar. Kush nuk e kthen borxhin për dhuratën e fituar, është person mosmirënjohës. Mosmirënjohja më e madhe e njeriut është harresa e borxhit që ia ka All-llahut xh.sh.

E tani mund të parashtroni pyetje dhe të thoni: si mund t'ia kthejë ndokush borxhin All-llahut xh.sh. për dhuratën që na e dhuroi? Përgjigjem: Më duhet të them, pasi që All-llahu xh.sh. ju bëri anëtarë të ummetit të Muhammedit a.s., mënyra më e mirë e falënderimit është të jeni besimtarë të sinqertë të Muhammedit a.s.. Pasi që u zgjodhi e u bëri nga anëtarët e bashkësisë muslimane, e vetmja rrugëdalje për larjen e borxhit është të qenurit tuaj muslimanë me gjithë zemër. Mënyrë tjetër nuk ka. Nëse nuk e lani borxhin, dënimi për këtë lëshim do të jetë i madh, aq sa ka qenë e madhe edhe dhurata. Le të na shpëtojë të gjithëve All-llahu xh.sh. nga një dënim i tillë! AMIN!

HAPI I PARË PËR T'U BËRË MUSLIMAN

Pas kësaj do të pyetni: si mund të bëhet njeriu musliman me plotë kuptimin e fjalës? Përgjigja në këtë pyetje kërkon sqarime të hollësishme, por unë me ndihmën e All-llahut xh.sh. do të mundohem, në ligjëratat e mia, t'i sqaroj me radhë në xhumatë e ardhshme. Por, sot do t'ua sqaroj atë që ka rëndësi të dorës së parë dhe që paraqet hapin parësor në këtë drejtim.

EMËRTIMI “MUSLIMAN” A KA KUPTIMIN E PREJARDHJES?

Ju lutem dëgjoni mirë që të kuptoni domethënien e fjalës “musliman”, fjalë të cilën shpesh e përdorni.

A thua vallë njeriu e sjell Islamin me vete kur lindë? Apo është musliman sepse është i biri apo nipi i muslimanit? A thua muslimani lind si musliman pikërisht siç lind francezi francez apo anglezi anglez? Vallë mos është muslimani emër i ndonjë kombi apo ndonjë race, siç është gjermani? Apo muslimani është musliman për atë se është i lindur në mesin e muslimanëve?

Çfarë përgjigje do t'ju jepni këtyre pyetjeve? Me siguri do të thoni: “Jo vëlla i dashur, njeriu i tillë nuk quhet musliman”. Muslimani nuk është musliman ngase i takon një grupi të caktuar të shoqërisë, por për shkak se e pranon Islamin dhe nëse ai heq dorë nga Islami, atëherë nuk mund të quhet musliman. Çdo person, qoftë brahman apo anglez, i bardhë apo i zi, me pranimin e Islamit do të integrohet në mënyrë të barabartë në bashkësinë muslimane, ndërsa personi i lindur në shtëpi muslimane, nëse e mohon Islamin, do të jetë i larguar nga bashkësia muslimane, edhe pse është biri i Veliut ose Nebijut.

Pra, këto janë përgjigjet tuaja lidhur me pyetjet e parashtruara. Nga këto përgjigje u vërtetua fakti se begatia më e madhe e All-llahut xh.sh., d.m.th. të qenurit musliman, e cila gjë ju gëzon dhe u bënë të kënaqur, nuk është rezultat i prejardhjes që e trashëgoni automatikisht nga prindërit tuaj dhe e cila e përcjellë tërë jetën në mënyrë mekanike, pa marrë parasysh faktin se a ju mundon apo ju gëzon një gjë e tillë. Nëse mundoheni dhe keni kujdes për këtë dhuratë, atëherë mund ta fitoni, por në qoftë se nuk kujdeseni për te, ajo gjithashtu mund të ju rrëmbehet. Zoti na ruajt!

KUPTIMI I PRANIMIT TË ISLAMIT

Më lejoni të vazhdoj. Thoni se njeriu bëhet musliman në qoftë se e pranon Islamit. Ju kisha pyetur: Ç'do të thotë të pranosh Islamit? Vallë mos mendohet se çdokush që thotë: “Unë jam musliman, ose unë e kam pranuar Islamit” është musliman? Apo nëse dikush e thotë një fjalë arabe, pa e kuptuar fare, menjëherë bëhet musliman? Që tash do të thoni se kuptimi i pranimit të fesë Islame pikësëpari qëndron në kuptimin e fjalës së shprehur, në pranimin e vetëdijshëm të asaj që ka mësuar dhe vepruar Muhammedi a.s., dhe në zbatimin e saj në jetën tonë të përditshme. Kush vepron kështu është musliman, e kush nuk vepron kështu nuk është musliman.

KËRKESA E PARË – DITURIA

Nga përgjigjja juaj vetvetiu del në shesh fakti se Islami në radhë të parë do të thotë dituri e pastaj zbatim i kësaj diturie në jetë. Njeriu mund të jetë turk apo arab edhe pse nuk e di se çka është, siç mund të jetë shqiptar apo boshnjak pa marrë parasysh se a është dijetar apo analfabet dhe kështu mund të mbetet tërë jetën, për shkak se si i tillë është lindur. Mirëpo, një person nuk mund të bëhet musliman me lindje, por me dituri. Nëse nuk di se kush është Muhammedi a.s., dhe në çka ka ftuar ai, atëherë pra si mundet të dëshmojë Pejgamberinë e tij dhe të veprojë sipas mësimit të tij? Nëse nuk e dëshmon me dituri dhe kuptim të plotë besimin në All-llahun xh.sh. dhe Pejgamberin a.s., si mund të bëhet musliman? Është e kuptueshme se njeriu analfabet nuk mundet të jetë musliman. Nuk mund të jetë musliman edhe pse lind në familje muslimane, vishet

me rroba muslimanësh, tregohet dhe prezentohet me emër muslimani, po edhe e quan veten musliman, nëse s'ka dituri. Mirëpo, ky person mund të jetë musliman me plotë kuptimin e fjalës nëse di se çka porosit feja Islame dhe dëshmon me vetëdije të plotë besimin në të. Dallimi ndërmjet muslimanit dhe kafirit nuk qëndron në veshmbathje, por dallimi i vërtetë qëndron në diturinë, që posedojnë ata të dy. Njëri është kafir sepse nuk di ndërlidhjen e ndërsjellë të tij me Zotin xh.sh., nuk di se cila rrugë është e drejtë dhe cila mënyrë e jetës është në pajtim me dëshirën e All-llahut xh.sh. Nëse një njeri lind në një familje muslimane, nga prindërit musliman, mirëpo nuk posedon dituri në këtë aspekt, atëherë në çka dallohet nga kafiri dhe pse thoni se njëri është musliman e tjetri kafir.

O njerëz! Ju lutem dëgjoni me vëmendje dhe mendoni mirë për këtë që po ju them. Duhet të kuptoni mirë se afërsia ose largësia juaj nga mëshira e All-llahut xh.sh., të cilin e falënderoni dhe e lavdëroni, varet nga dituria që e posedoni. Pra, duhet të dini mirë se dashuria juaj ndaj Islamit është e varur nga dituria juaj për te dhe nëse nuk posedoni dituri të vërtetë, nuk mund të keni edhe dashuri të vërtetë ndaj Islamit. Por, edhe dituria e pakët nuk do të bëjë dobi, sepse përherë do të ekzistojë rreziku për ta humbur këtë dhuratë të çmuar të All-llahut xh.sh. (Islamit). Një person që nuk e di dallimin e vërtetë ndërmjet Islamit dhe kufrit, si dhe mospërputhjen e Islamit me shirkun, është i njëjtë me atë që përcjellë gjurmë në terr. Duke përcjellë vijën e drejtë të hapave të tij, mundet ta devijojë rrugën duke mos qenë i vetëdijshëm për devijimin e tij nga rruga e drejtë. Po ashtu, mund të ndodhë që në rrugë të takon dëhallin, i cili mund t'i thotë: “Biri im! E ke humbur rrugën në errësirë, eja të të dërgoj në vendin ku ja ke mësyer”. Udhëtari i giorë, pasi që është i rrethuar me errësirë, nuk mund ta sheh rrugën e drejtë me sytë e tij. E për këtë shkak do ta kapë papandehur dëhallin për dore, dhe ky do ta largojë nga rruga e drejtë. Me këto rreziqe

ballafaqohet udhëtari për arsye se nuk ka dritë të nevojshme me vete, duke mos qenë i aftë t'i vërejtë shenjat në rrugë. Po të kishte pasur dritë me vete as që do ta kishte humbur rrugën e as që do ta largonte ndokush nga rruga e drejtë dhe e vërtetë. Nga kjo mund të konkludojmë se rreziku më i madh që i kanoset muslimanit është mosnjohja e mësimëve të Islamit dhe mosnjohja e këshillave të Muhammedit a.s. Nga mungesa e diturisë do ta kërkojë rrugën me prekje në mënyrë të verbër, derisa ta largojë nga rruga e drejtë dexhalli i mallkuar. Por, nëse është i bekuar me dritën e diturisë, do të jetë në gjendje të shohë rrugën e qartë të fesë Islame në çdo hap të jetës së tij, do t'i zbulojë dhe do të largohet nga rrugët e gabuara të kufrit, të shirkut dhe të besëtytnive, të cilat do të mundohen ta ndalin dhe kudo që do të takohet me ndonjë lajthitje, pas një bisede të shkurtër do të kuptojë shpirtligësinë e tij, ndaj nuk do ta pasojë.

RËNDËSIA E DITURISË

Vëllezër! Nga kjo dituri, për nevojën e së cilës po ju shpjegoj, varet ekzistenca juaj dhe e fëmijëve tuaj si muslimanë. Kjo nuk është çështje e thjeshtë, që mund të lihet pas dore. Asnjëherë nuk tregoni kurrfarë përtacie në përpunimin e tokës, në ujitjen e saj, në shkuarjen në punë ose në hapjen e ndonjë shitoreje, sepse mospunimi nuk sjell bereqet, nuk sjell fryte e lëndë ushqyese, dhe në një rast të tillë mund të vdisni nga uria dhe të humbni çështjen më të shtrenjtë - jetën. Andaj më thuani përse tregoni përtaci në të fituarit e diturisë nga e cila varet ekzistenca juaj si muslimanë. A nuk mund të jetë si pasojë e kësaj rreziku për largimin e dhuratës së All-llahut xh.sh. (Imanit) nga duart tona? A nuk është besimi (Imani) gjëja më e dashur dhe më e çmuar se

të mirat e kësaj bote, po edhe më e dashur se jeta? A nuk mund të shpenzoni të dhjetën pjesë të kohës dhe të mundit tuaj në vepra që do ta mbrojnë Imanin (besimin) tuaj?

Nuk them se çdokush prej jush duhet të bëhet dijetar i madh, të lexojë shumë libra dhe t'i harxhojë dhjetë deri dymbëdhjetë vjet të jetës së tij në lexim dhe në studim. Nuk ka nevojë të lexosh aq shumë për të qenë musliman, por vetëm një orë brenda njëzet e katër orëve. Çdo musliman i ri ose plak, grua ose burrë, duhet të ketë aq dituri sa të kuptojë thelbin e mësimin Kur'anor dhe qëllimin e shpalljes së tij. Duhet të jetë i aftë të kuptojë thirrjen e Muhammedit a.s., me të cilën ai ka ardhur në këtë botë; atë që ka qenë e shtrembër e që ai ka dëshiruar ta shkatërrojë dhe atë që ka qenë e mirë, e që ai ka dëshiruar ta përforcojë. Muslimani duhet të ketë aq dituri sa të njoftohet me mënyrën e veçantë të jetës, të cilën All-llahu ua ka përcaktuar muslimanëve. Nuk nevojitet shumë kohë për të fituar kaq dituri. Nëse e doni fenë Islame nuk është rëndë të ndani një orë në ditë për mësim fetar.

DALLIMI I VËRTETË NDËRMJET MUSLIMANIT DHE KAFIRIT PSE KA DALLIM NDËRMJET MUSLIMANIT DHE KAFIRIT? VËLLEZËR MUSLIMANË!

Çdo musliman personalisht beson, po sigurisht edhe ju besoni, se grada e muslimanit është më e lartë se grada e kafirit (nëse ka ndonjë gradë kafiri - sh.p.). All-llahu xh.sh. i do muslimanët, kurse

nuk i do kafirat. Muslimani do të shpëtojë, kurse kafiri jo. Muslimani do të shkojë në xhennet, kurse kafiri në xhehenem.

Sot dua të mendoni rreth çështjeve që e bëjnë të domosdoshëm dallimin ndërmjet muslimanit dhe kafirit. Edhe kafiri është biri i Ademit a.s. sikur edhe ju, është qenie njerëzore sikur edhe ju, ka duar, këmbë dhe veshë si edhe ju. Po ashtu thith të njëjtin ajër që e thithni edhe ju, pinë ujin e njëjtë, banon në të njëjtën tokë ku banoni edhe ju. I njëjti All-llah xh.sh. që u krijoi juve i krijoi edhe ata. Mirëpo, përse grada e tyre është më e ulët, kurse juaja është më e lartë? Përse ju do të fitoni xhennetin, e ata do të hudhen në xhehenem?

VALLË MOS ËSHTË DALLIMI VETËM NË EMËR?

Kjo është pyetje që kërkon analizë të thellë. Një dallim aq i madh nuk mund të dalë nga fakti se ju quheni Abdullah e ai quhet Vilijam, ose pse ju jeni bërë sunnet e ai jo, ose pse ju hani mishin e ai jo. All-llahu xh.sh., i cili i krijoi të gjitha qeniet njerëzore dhe i cili i ushqen të gjithë, është e pamundur të bëjë dallim ndërmjet krijesave të Tij, në baza aq të vogla dhe njërin rob të Tij ta çojë në xhennet, kurse tjetrin në xhehenem.

DALLIMI I VËRTETË - ISLAMI DHE KUFRI

Nëse një dallim i tillë nuk është me vend, atëherë pra mendoni mirë se cili mund të jetë dallimi i vërtetë ndërmjet atyre dyve. Përgjigjja është një, ajo është se dallimi i vërtetë ndërmjet këtyre dy njerëzve ekziston për shkak të Islamit dhe kufrit. Islam do të thotë t'i nënshtrohesh All-llahut xh.sh., ndërsa kufër mos t'i nënshtrohesh All-llahut xh.sh. Muslimani dhe kafiri, që të dy janë krijesa njerëzore, që të dy janë robër të All-llahut xh.sh. Mirëpo, njëri prej tyre ngritet në një gradë më të lartë për arsye se e pranon All-llahun xh.sh., u nënshtrohet urdhërave të Tij dhe frikësohet nga pasojat e mosdëgjimit, kurse tjetri bie në një gradë të ulët për shkak se nuk pranon All-llahun xh.sh. dhe nuk i zbaton urdhërat e Tij. Ky është dallimi dhe shkakun përse All-llahu xh.sh. është i kënaqur me muslimanët, kurse i hidhëruar me kafirat.

SHKAKU I DALLIMIT - DITURIA DHE VEPRA

Nga kjo që thamë gjer më tani shohim qartë se ekzistojnë dy gjëra që e dallojnë muslimanin nga kafiri. Njëra është dituria, kurse tjetra - vepra. Në radhë të parë njeriu duhet ta dijë se kush është Zoti i tij, cilat janë urdhërat e Tij, cila është mënyra për të përcjellë dëshirën e Tij, cilat vepra i pëlqejnë dhe me cilat vepra nuk është i kënaqur. Pastaj, kur t'i mësojë këto gjëra, njeriu duhet t'i bëhet rob All-llahut xh.sh., të veprojë ashtu siç ka urdhëruar All-llahu xh.sh., e jo si dëshiron epshi i tij. Nëse zemra e tij dëshiron diçka që është në kundërshtim me dispozitat Islame, nuk duhet vënë re dëshirës së zemrës, por duhet respektuar urdhërat e All-llahut xh.sh. Nëse sheh

ndonjë vepër që i duket me vlerë, kurse All-llahu xh.sh. për të njëjtën vepër thotë se nuk është e vlefshme, në këtë rast muslimani duhet dëgjuar All-llahun xh.sh, dhe të largohet nga ajo vepër. Por nëse e sheh një vepër të pavlefshme, mirëpo e njëjta vepër tek All-llahu xh.sh. ka vlerë, atëherë muslimani duhet ta vlerësojë atë që e ka vlerësuar All-llahu xh.sh. Nëse sheh dëm në ndonjë vepër që All-llahu xh.sh. ka urdhëruar të veprohet, muslimani medoemos duhet të veprojë edhe pse duke vepruar në këtë vepër mund ta sjell në rrezik pasurinë dhe jetën e tij. Përkundrazi, nëse në ndonjë vepër sheh fitim të madh, kurse All-llahu xh.sh. kryerjen e kësaj vepre e ka ndaluar, muslimani nuk guxon as t'i afrohet kësaj vepre edhe pse mund t'ia sjellë pasurinë e mbarë botës.

Kjo është dituria dhe vepra e muslimanit, me të cilat muslimani bëhet rob i vërtetë i All-llahut xh.sh. dhe të cilin Ai e bekon dhe i afron nder dhe fisnikëri. Përkundrazi, kafiri, pasi që nuk ka dituri vepron si rob i padëgjueshëm i All-llahut xh.sh. dhe me këtë largohet nga mëshira e Tij.

Kuptuam dhe pamë se dallimi ndërmjet muslimanit dhe kafirit nuk qëndron në emrin, veshjen dhe ushqimin e tyre, por në diturinë dhe veprën e tyre, dhe muslimani nuk mund të ketë gradë më të lartë se kafiri përderisa dituria dhe veprat e tij janë të njëjta me të kafirit. E nëse nuk i ka këto gjëra (diturinë dhe veprat), nuk e meriton mëshirën e All-llahut xh.sh. Islami nuk është afërsi për nga raca ose për nga familja ose për nga vëllazëria. Islami, te fëmijët, nuk trashëgohet vetvetiu nga prindërit. Nuk është rast i njëjtë sikur te amerikani i pasur, pasurinë e të cilit e trashëgon i biri si dhe fakti se, edhe pse nuk ka dituri e vepër, zë vend me rëndësi në shoqëri mu për atë shkak se është i biri i pasanikut, kurse i biri i të varfërit do të mbetet në klasën e ulët vetëm pse është lindur në familje të varfër. Për këtë flet qartë Kur'ani a.sh.: “S”ka dyshim se tek All-llahu më i ndershmi ndër ju është ai që më tepër është ruajtur (nga të këqijat) ...”. (Kur’ani; 49:13)

Kjo do të thotë se kush ka dituri dhe kush i përulet më tepër All-llahut xh.sh. ka vlerë më të madhe tek ai, pa dallim a është i pasur apo i varfër. Ibrahim i a.s. u lind në shtëpi të idhujtarëve, por me hulumtimet e tija arriti dituri për Zotin xh.sh. dhe iu përul, e për këtë shkak All-llahu xh.sh. e bëri imam të mbarë njerëzimit. Përkundër kësaj kemi djalin e Nuhit a.s., i cili u lind në familje të Pejgamberit, por nuk mësoi, nuk fitoi dituri për All-llahun xh.sh. dhe nuk iu përul. Për këtë shkak All-llahu xh.sh. e dënoi dhe e bëri shembull për mbarë njerëzinë. Ju lutem të kuptoni se dallimi ndërmjet muslimanit dhe kafirit është në dituri dhe në vepra, kurse mëshira e All-llahut xh.sh. do të zbres mbi ata, që e ndjekin rrugën e All-llahut xh.sh., në të cilën rrugë ishte Muhammedi a.s. dhe shokët e tij (radijall-llahu anhum). Nëse nuk i posedojnë këto cilësi dhe dallime, para All-llahut (Xhel-le she'nuhu) do të jenë të njëjtë, pa marrë parasysh se njëri quhet Abdur-Rahim e tjetri Martin, dhe nuk do të kenë të drejtë në mëshirën e All-llahut xh.sh.

PËRSE MUSLIMANËT SOT JANË TË POSHTËRUAR?

Vëllezër! E quani vetveten muslimanë dhe jeni të bindur se All-llahu xh.sh. muslimanët i shikon me sy të mëshirës, mirëpo hapni sytë mirë dhe shikoni a është e pranishme ndër ju mëshira e Tij. Ç'do të ndodhë në Ahiret do të shihni atje, mirëpo duhet të shohim ç'na ka ndodhur këtu në këtë botë. Jemi 90 milionë muslimanë në këtë vend. (Ligjëratat janë mbajtur në kohë të sundimit britanik në Indinë e pandarë). Aq shumë jeni sa që sikur secili prej jush të marrë nga një gur dhe t'i hudhni në një vend do të bëhej një kodër. Por, pikërisht këtu ku ka aq shumë muslimanë, pushteti është në duar të kafirave. Në duart e tyre janë kokat tuaja, të cilat i lëvizin nga kanë

dëshirë; kokat tuaja, që nuk i janë përlulë askujt pos All-llahut xh.sh., tash po u përlulen qenieve njerëzore. Nderi juaj, të cilin më parë nuk guxonte ta prekë askush, tash është pluhurosur. Dora juaj, e cila ishte gjithmonë lartë, tash është shtrirë para kafirit. Analfabetizmi, varfëria, borxhet,... ju ndjekin çdokund, ashtu që u sjellë në atë situatë që të mos mund ta ngritni kokën nga turpi.

Vallë, a kjo është mëshirë e All-llahut xh.sh.? Nëse nuk është mëshirë duhet të jetë mlllef, mirëpo a nuk është për t'u habitur kjo gjë, muslimanë jeni e mbi ju mlllef i All-llahut xh.sh.? Muslimanë jeni, por edhe më tej jetoni në turp! Muslimanë jeni, por edhe më tej jetoni në robëri! Një gjë e tillë është e pamundur, mu sikur që është e pamundur të jetë e zeza e bardhë. Pasi që All-llahu xh.sh. i donë muslimanët, vallë përse i ka turpëruar? Vallë mos është All-llahu xh.sh. tiran (Zoti na faltë) dhe lejon që mbi ju të sundojnë kafirat, edhe pse ju besoni dhe i përlulen urdhërave të Tij. Nëse jeni të mendimit se All-llahu xh.sh. nuk është tiran dhe nëse besoni se shpërblimi për adhurimin e bërë nuk mund të jetë poshtërimi, atëherë pra, duhet kuptuar se gabimi qëndron tek ju, që do të thotë se nuk jeni muslimanë në plotëkuptim të fjalës. Edhe pse emri juaj në librin amzë të shtetit figuron si emër muslimani, duhet të dini se All-llahu xh.sh. nuk e pranon saktësinë e pushtetit britanez. All-llahu xh.sh. ka pushtetin e vet dhe nëpunësit e Tij, andaj ju duhet kërkuar emrin tuaj në Librin e All-llahut xh.sh., që të shihni se a jeni nga robërit e dëgjueshëm apo nga robërit e padëgjueshëm?

All-llahu xh.sh. ka zbritur Kur'anin a.sh. për ta lexuar dhe për ta mësuar mënyrën e adhurimit të All-llahut xh.sh. A jeni munduar ndonjëherë të zbuloni se çka shkruan në te? All-llahu xh.sh. e ka dërguar Pejgamberin e Tij për të ju mësuar se si të bëheni muslimanë. Mirëpo, a jeni përpjekur ndonjëherë të zbuloni se çka përmban mësimi i Muhammedit a.s.? All-llahu xh.sh. ju tregoi rrugën, në të cilën rrugë mund të fitoni nder dhe fisnikëri në këtë botë dhe në botën e ardhshme.

Mirëpo a keni ecur nëpër këtë rrugë? All-llahu xh.sh. ju tregoi qartë veprat që ju poshtërojnë në këtë botë dhe në botën tjetër. A jeni larguar nga këto vepra? Vallë a keni ndonjë përgjigje për pyetjet e parashtruara? Nëse nuk keni fituar dituri nga Kur’ani a.sh. dhe nga jeta e Muhammedit a.s. dhe nëse nuk e përcjellni rrugën, të cilën ju tregoi All-llahu xh.sh., përmes Muhammedit a.s., si do të mund të bëheni muslimanë që e meritojnë shpërblimin e Tij. Shpërblimi i fituar është ekuivalent me jetën tuaj si muslimanë e të njëjtin shpërblim do ta fitoni edhe në botën tjetër.

Më lartë thashë se nuk ka dallim ndërmjet muslimanit dhe kafirit, pos në dituri dhe në vepra. Mirëpo, nëse dituria dhe veprat e muslimanit janë të njëjta me ato të kafirit, e ky edhe më tej e quan veten musliman, thotë një gënjeshtër të madhe. Kafiri nuk lexon Kur’an dhe nuk di se ç’shkruan në te. Nëse edhe muslimani nuk lexon Kur’an dhe nuk di se çka shkruan në te, përse të quhet musliman? Kafiri nuk e di mësimin e Pejgamberit a.s. dhe cilën rrugë duhet pasuar. Nëse edhe muslimani është në këtë gjendje, si mund të quhet musliman? Kafiri e pason epshin e tij në vend se të pasojë rrugën e All-llahut xh.sh. Nëse edhe muslimani është kokëfortë dhe e pason epshin e tij dhe idenë e tij, nuk dëgjon urdhërat e All-llahut xh.sh. dhe bëhet rob i dëshirave të tija shtazarake, atëherë me çfarë të drejte e quan veten musliman (rob i nënshtruar ligjeve të All-llahut xh.sh.)? Kafiri nuk bën dallim ndërmjet hallallit dhe haramit, e merr çdo send që është tërheqës dhe i dobishëm sipas mendimit të tij, pa marrë parasysh se a është hallall apo është haram. Nëse edhe muslimani vepron siç vepron kafiri, atëherë ku qëndron dallimi ndërmjet tyre? Thënë shkurt: nëse muslimani ka dituri aq sa ka edhe kafiri, dhe nëse vepron ashtu si vepron kafiri, përse të konsiderohet me gradë më të lartë në krahasim me kafirin dhe përse mos të jetë dënimi i tij i njëjtë me dënimin e kafirit? Këto janë gjëra për të cilat duhet të mendojmë thellë dhe me zgjuarsi.

LËNDË PËR SHQYRTIM SERIOZ

Vëllezër të dashur! Mos mendoni se jam i gatshëm t'i emëroj muslimanët si kafira. Jo, këtë nuk kam për qëllim aspak. Por mendoj dhe dua që secili prej jush të mundohet të gjejë shkakun e vërtetë përse All-llahu xh.sh. na ka privuar nga dhuntitë e Tij? Përse jemi cak fatkeqësie në të gjitha anët? Përse kafirat, në realitet robërit e padëgjueshëm të All-llahut xh.sh. të na sundojnë? Përse ne, muslimanët, robërit e dëgjueshëm të All-llahut xh.sh., jemi të poshtëruar dhe të shtypur? Sa më tepër që kam menduar për këtë gjendje, aq më tepër jam bindur se dallimi i vetëm që ka mbetur ndërmjet muslimanit dhe kafirit është emri, sepse i kryejmë të njëjtat vepra, e kemi lënë pas shpine All-llahun xh.sh., nuk i frikësohemi dhe nuk e dëgjojmë Atë mu sikur edhe kafirat. Natyrisht, ekziston një dallim i vogël ndërmjet nesh dhe atyre, mirëpo ky dallim nuk na jep të drejtë për shpërblim. Në realitet, kjo bën që të meritojmë dënim më të madh, sepse e dimë se Kur'ani a.sh. është libër i All-llahut xh.sh., kurse sillemi me të sikur që sillen edhe kafirat. Dimë se Muhammedi a.s. është Pejgamber i All-llahut xh.sh., mirëpo frikësohemi ta pasojmë rrugën e tij, sikurse frikësohen kafirat. Dimë se All-llahu xh.sh. e ka mallkuar gënjeshtarin, e ka shpallur qartë se xhehenemi është vendbanim i atyre që marrin dhe japin rryshfet, se ata që japin dhe marrin kamatë janë njerëz më të padrejtë, se ai që përgojon është sikur ai që e hanë mishin e vëllait të vet të vdekur dhe ka shpallur se ata që jetojnë jetë amorale, luksoze dhe të shfrenuar i pret dënim i madh. Por edhe pse i dimë këto, pa kurrfarë ngurrimi i bëjmë ashtu siç veprojnë edhe kafirat, sikur në zemrat tona nuk ka frikë ndaj All-llahut xh.sh.. Ky është shkaku që nuk jemi të shpërblyer, jemi muslimanë vetëm me emër, kurse me vepra jemi të njëjtë me kafirat. Për këtë

shkak edhe na sundojnë kafirat, kurse torturat e maltretimet janë rezultat i padrejtësisë sonë ndaj mirësisë së dhuruar - Islamit - nga ana e All-llahut xh.sh..

Vëllezër të dashur! Me këtë që fola në këtë ligjëratë nuk kisha për qëllim t'ju fajësoj. Nuk kam ardhur me këtë qëllim. Qëllimi im është t'ua bëjë të mundshme të gjeni atë që keni humbur, e do të përpiqemi ta gjejmë sendin e humbur, atëherë kur do të kuptojmë vlerën dhe rëndësinë e këtij sendi. Për këtë unë dua të ju zgjoj nga gjumi. Nëse zgjoheni dhe vërtetë kuptoni vlerën dhe rëndësinë e dhuratës më të çmuar që keni pasur në dorë, atëherë përsëri do të përpiqeni që ta fitoni.

DËSHIRA PËR TË FITUAR DITURI

Në ligjëratat e kaluara thashë se dituria për Islamin është kushti i parë për t'u bërë musliman i vërtetë. Çdo musliman medoemos duhet të dijë çka mëson Kur'ani a.sh., cilin sistem e ka pasuar Muhammedi a.s., ç'është Islami dhe cilat janë veprat që e ndajnë Islamin nga kufri. Askush nuk mund të bëhet musliman pa këtë dituri. Mirëpo, shkak për brengosje qëndron në mosdëshirën tuaj për të fituar këtë dituri. Kjo tregon se ende nuk jeni zgjuar e të shikoni se çfarë mirësie keni humbur. Vëllezër! Nëse fëmija nuk qanë, nëna nuk i jep gjë. Kur eshtohet, njeriu vetë kërkon ujë, e All-llahu xh.sh. edhe ujin e ka krijuar për të.

Nëse nuk jemi të etshëm për ujë, edhe në qoftë se paraqitet një burim përplotë me ujë, uji do të jetë i pavlefshëm. Në radhë të parë, duhet të kuptoni se në çfarë humbje jeni për atë që nuk keni

dituri për dinin tuaj. Në disponim e keni Librin e All-llahut xh.sh., mirëpo ju nuk dini se ç'ka brenda. A ka humbje më të madhe se kjo? Po ju madje nuk dini edhe kuptimin e shehadetit, me thënien (shprehjen) e së cilës hyni në Islam, e nuk dini edhe çfarë detyrash ju presin pas shprehjes së shehadetit. A ka dhe a mundet të ketë humbje më të madhe për muslimanët se kjo? Ju e konsideroni si humbje vetëm kur t'ju digjet gruri, i dini lodhjet e pasuksesshme në fitimin e kafshatës së bukës, të gjitha këto i dini, vetëm nuk dini se sa humbni kur ju mungon njohuria për Islamin. Kur ta kuptoni këtë dëm, vetë do të vini dhe do të luteni për shpëtim nga kjo humbje. E kur ta kërkonti vetë këtë gjë, atëherë insha-All-llah (nëse don All-llahu xh.sh.) do të rregullohet mbrojtja juaj nga kjo humbje.

FAKTE PËR PËRSIATJE TË THELLA QËNDRIMI YNË NDAJ KUR'ANIT A.SH.

Vëllezër muslimanë! Sot muslimanët janë të vetmit njerëz të lumtur në botë, të cilët e kanë ruajtur në tërësi fjalën e All-llahut xh.sh., nuk ka të futur në të asgjë, e ruajtur fjalë për fjalë, pikërisht ashtu sikur që i është shpallur Muhammedit a.s.. Të njëjtët muslimanë janë njerëz të mjerë, të cilët me vete e kanë fjalën e All-llahut xh.sh. (Kur'anin a.sh.), mirëpo janë të zhveshur nga bekimi dhe begatitë e shumta të saja. Kur'ani a.sh. i është shpallur njerëzisë për ta lexuar, për ta kuptuar dhe për të punuar sipas tij, dhe me ndihmën e tij të përforcojnë në tokë një bashkësi që do të jetojë në pëlqim me ligjin e All-llahut xh.sh.. Kur'ani a.sh. ka zbritur për t'ua pranuar nderin dhe fuqinë

muslimanëve, është zbritur për t'i bërë zëvendës (mëkëmbës) të vërtetë të All-llahut xh.sh. në tokë. Këtë e vërteton vetë historia. Kur jetuan muslimanët në pajtim me ligjin e All-llahut xh.sh., All-llahu xh.sh. me fuqinë e Tij u mundësoi që të bëhen Imamë dhe të parë të botës. Mirëpo, sot dobia e Kur'anit a.sh. është e kufizuar. Ka ardhë deri atje puna, saqë muslimanët e shfrytëzojnë Kur'anin për largimin e lugetërve nga shtëpitë e tyre, për shkrimin e ajeteve të shenjta nëpër letra, të cilat i varin në qafë apo i fusin në ujë, të cilin më vonë e pinë ose për leximin e pavetëdijshëm të përmbajtjes së Kur'ani Kerimit për të fituar bile diçka nga bekimi i All-llahut xh.sh.. Tash më muslimanët nuk kërkojnë në të udhërrëfyes për problemet e përditshme të jetës së tyre. Nuk kërkojnë këshilla për besimin e tyre, për veprat e tyre, nuk pyesin se si të punojnë, si të fitojnë miq e si të sillen ndaj armiqve, cilat janë të drejtat e fëmijëve dhe të drejtat tona, ç'është për neve e vërtetë dhe ç'është gënjeshtër, kë duhet respektuar e kë nuk duhet, kë e kemi mik e kë armik, ku qëndron nderi, mirëqenia dhe fitorja e ku qëndron turpi, fatkeqësia e humbja?

Muslimanët njohjen e të gjitha këtyre sendeve nuk e bëjnë nga Kur'ani a.sh.. Të gjitha këto i mësojnë nga kafirat, politeistët, nga njerëzit e humbur dhe vetjakë, nga zëri trishtues i hevasë së tyre dhe i pasojnë e i përcjellin në jetën e tyre. Ajo që sipas rendit çdo herë ndodhë me njerëzit që nuk e respektojnë dhe që e harrojnë All-llahun xh.sh., ka ndodhë dhe po ndodhë në Indi, Kinë, Javë, Palestinë, Siri, Algjeri, Maroko dhe gjithkund.

Kur'ani është burim i të mirës më të madhe. Ai është i gatshëm të japë çka të doni dhe sa të mira të dëshironi. Nëse nga ai kërkon sende të thjeshta, të pavlerë dhe jo të vërteta, sikur që është largimi i shejtanëve dhe shpirttrave të lig, ilaç për koll dhe për nxehtësi, sukses në gjyq, në jetë dhe në punë, atëherë do t'i fitoni vetëm këto sende. E nëse kërkonit të udhëheqni me botën dhe të arrini kulmin e kënaqësisë edhe atë do ta arrini. Kur'ani a.sh. edhe këto të mira ka mundësi t'i

dhurojë. Këtu kemi të bëjmë me aftësinë tuaj personale që të kërkonit dy pika nga Oqeani, përndryshe Oqeani është i gatshëm t'u dhurojë dhuratë aq të madhe aq sa është edhe vetë.

Vëllezër! Talljet e mëdha që i bëjnë vëllezërit tanë muslimanë me Librin e Shenjtë të All-llahut xh.sh. aq janë të thjeshta, saqë nëse ata vetë e shohin ndokend që bën tallje të tillë në ndonjë rast tjetër, do të qeshnin bile edhe do ta konsideronin të çmendur. Më tregoni, a ka marrë ndokush recetë nga mjeku dhe a e ka varur atë rreth qafe, pasi që e ka mbështjellë me ndonjë leckë, ose ta ketë zhytur në ujë dhe atë ujë ta ketë pirë? Ç'do të thonit në këtë rast? A nuk do të qeshnit me të, a nuk do ta kishit konsideruar të çmendur? Mirëpo, e njëjta lojë po ndodh para syve tuaj me recetën më të madhe të Mjekut më të Madh, në të cilën është shkruar bari i mëshirshëm për të gjitha dobësitë dhe sëmundjet tuaja, e askush nuk qeshë? Askush nuk mund të kuptojë se receta nuk është send që varet në qafë ose send që laget në ujë, por qëllimi i saj është që të merret bari i rekomanduar në të.

ME RËNDËSI ËSHTË QË TË KUPTOHET DHE TË PASOHET KUR'ANI A.SH.

Më thuani a ka marrë ndonjë i sëmurë të lexojë ndonjë libër të medicinës duke menduar se leximi i atij libri do ta shërojë? Ç'do të kishit thënë për njeriun e tillë? A nuk do ta kishit konsideruar të çmendur dhe dërguar në spitalin e të çmendurve? Mirëpo, të njëjtën gjë po e bëni me recetën e Mjekut më të Madh që e ka shpallur si bar për sëmundjet tuaja. E prapëseprapë nuk ju kon-

siderojmë të çmendur dhe nuk ju dërgojmë në çmendinë! Ju e lexoni dhe mendoni se me lexim të kujdesshëm të gjitha sëmundjet shërohen, dhe se nuk ka nevojë për përcjelljen e udhëzimeve të dhëna në te, e as që është me rëndësi t'u largoheni sendeve që janë të emëruara si të dëmshme. Përse nuk e konsideroni veten të njëjtë me të parin?

Nëse merrni ndonjë letër në ndonjë gjuhë tjetër që nuk e kuptoni, do të shpejtoni të gjeni njeriun që e njeh atë gjuhë për ta kuptuar përmbajtjen e asaj letre. Kështu veproni me letrat zyrtare, të cilat mund t'u sjellin dobi materiale. Mirëpo letrën e Sunduesit të botëve, në të cilën i përshkruan të gjitha të mirat e kësaj dhe të asaj bote, e lini pas dore, pa dëshirë për ta kuptuar përmbajtjen e saj. Nuk tregoni kurrfarë interesi për kuptimin e porosisë së saj. A nuk është kjo për t'u habitur?

PASOJAT E PADREJTËSISË NDAJ LIBRIT TË ALL-LLAHUT XH.SH.

Këtë që e flas, nuk e flas për dëfrim, por nga brengosja që ju nuk i kuptoni këto fakte. Nëse mendoni pak më thellë për këto fakte, zemra juaj do të kuptojë se padrejtësia më e madhe në botë i është bërë Librit të All-llahut xh.sh., kurse persekutues janë pikërisht ata njerëz, që pohojnë se besojnë në këtë libër dhe se janë të gatshëm të sakrifikojnë jetën për të. Nuk ka dyshim se ata besojnë dhe e duan atë më tepër se jetën e tyre, mirëpo fatkeqësisht pikërisht mu ata e bëjnë padrejtësinë më të madhe ndaj tij. Pasojat e padrejtësisë së tyre ndaj Librit të All-llahut xh.sh. janë të dukshme. E nëse mendoni pak për këto fakte, do të kuptoni se fjala e All-llahut xh.sh. nuk i

është shpallur njeriut që ta futë në fatkeqësi, në mjerim dhe në vuajtje: “Ta Ha. Ne nuk ta shpallëm Kur’anin për të të munduar ty.” (Kur’ani; 20:1-2).

Kur’ani a.sh. është burim i mëshirës dhe i fatmirësisë e jo i fatkeqësisë e i mjerimit. Absolutisht është e pamundur të notojë në fatkeqësi dhe në mjerime një popull që posedon fjalën e All-llahut xh.sh., të vuaj nën zgjedhën e të tjerëve, të jetë i shkelur dhe i rrahur nga ata që i kanë nën zgjedhë dhe që i tërheqin mu si kafshë, si të duan dhe ku të duan. Ky fat një popull mund ta kaplojë vetëm atëherë kur t’i bëjë padrejtësi fjalës së All-llahut xh.sh.. Për ilustrim kemi fatin e beni Israilëve. U është shpallur Teurati dhe Inxhili dhe u është thënë: “Dhe sikur ta zbatonin Tevratin, Inxhilin dhe Kur’anin, që u zbritën nga Zoti i tyre, ata do të kishin furnizim me bollëk nga qielli dhe nga toka. Është një grup i drejtë (i matur) prej tyre, por është e keqe ajo që punojnë shumica prej tyre.”(Kur’ani; 5:66). Por i kanë bërë padrejtësi Librit të All-llahut xh.sh. dhe i kanë përjetuar pasojat e asaj padrejtësie: “E mbi ta rëndoi poshtërimi dhe skamja, e ata kundër vetes shkaktuan hidhërimin e All-llahut. Kjo ndodhi ngase ata mohonin argumentet e All-llahut, mbytnin Pejgamberët pa kurrfarë të drejte, dhe për shkak se kundërshtuan dhe i kalonin kufijtë në të keqe.” (Kur’ani; 2:61)

Andaj, nëse një popull e ka Librin e All-llahut xh.sh., por edhe më tej është i shtypur dhe i shkelur, atëherë sigurisht kupton se i bënë padrejtësi Librit të All-llahut xh.sh. dhe i gjithë ky dënim është pasojë e padrejtësisë. Rrugë dhe shpëtim tjetër nuk ka pos ndërprerjes së padrejtësisë të cilën e bëni dhe t’ia ktheni Atij atë që i Takon. Nëse nuk ndaleni së vepruari këtë mëkat, gjendja juaj nuk do të përmirësohet edhe pse mund të hapni fakultete në çdo fshat, të gjithë fëmijët tuaj mund të kenë diploma dhe mund të bëheni milionerë.

KUSH QUHET MUSLIMAN?

Vëllezër! Me rëndësi të madhe është që çdo musliman të dijë kush quhet musliman dhe cili është kuptimi i fjalës “musliman”. Nëse ndodh që një qenie njerëzore nuk di se ç’është njerëzia dhe cili është dallimi ndërmjet njeriut dhe kafshës, ai, natyrisht, do t’i durojë sjelljet e vrazhda të kafshëve dhe nuk do të kuptojë se ai është njeri. Njëlloj me këtë, nëse njeriu nuk di ç’është vlera e vërtetë e të qenurit musliman dhe nëse nuk di pikat ndarëse të muslimanit prej jomuslimanit, ai do të veprojë si jomusliman dhe nuk do të shijojë përparësinë e Islamit. Për këtë shkak çdo musliman dhe fëmijë i çdo muslimani doemos duhet të dijë domethënien e të quajturit musliman, përgjegjësitë që i ka ky musliman, kufijë e Islamit brenda të cilëve është musliman; kundërvajtjet që e nxjerrin nga Islami edhe pse ai veten edhe më tej e quan musliman.

KUPTIMI I ISLAMIT

Islam do të thotë nënshtrim dhe dëgjueshmëri All-llahut xh.sh. Të dorëzosh veten All-llahut xh.sh. është Islam. Të lësh lirinë dhe pavarësinë tënde për nder të All-llahut xh.sh. është Islam. T’i lëshohesh autoritetit dhe pushtetit suprem të All-llahut xh.sh. është Islam. Ai që ia beson jetën e vet All-llahut xh.sh. është musliman, kurse ai që sendet jetësore i mban në duar të veta apo ia beson tjetërkujt, nuk është musliman. T’ia besosh veten All-llahut xh.sh. do të thotë të pranosh udhërrëfimin e Tij të shpallur përmes Muhammedit a.s., pa kurrfarë devijimi. Me rëndësi është të pasohet vetëm Kur’ani a.sh. dhe sunneti i Muhammedit a.s. në çdo problem jetësor. Përsëris

prap, musliman është vetëm ai person, që i hedh poshtë dëshirat e veta personale, traditat botërore, dhe këshillat e kujtdo qoftë, pos All-llahut xh.sh.. Ai që në çdo rast kërkon këshilla në Librin e All-llahut xh.sh. dhe në sunnetin e Muhammedit a.s., për të mësuar se çka duhet vepruar e çka nuk duhet vepruar, dhe të pranojë pa hamendje çdo udhëzim, i cili e orienton në të mirë (hajr) dhe të hudhë poshtë çdo vepër që është në kundërshtim me të, edhe atë për shkak se ia ka besuar plotësisht vetveten All-llahut xh.sh., e ky nënshtrim e lëshim nën mbikëqyrjen e All-llahut xh.sh. do të thotë të jeshë musliman. E me siguri nuk është musliman një person që nuk varet nga Kur’ani a.sh. dhe nga sunneti i Muhammedit a.s., por i pason udhëzimet e ndjenjave të veta apo pason traditën e të parëve të tij ose merr mësim nga ndodhitë e botës, pa marrë parasysh se a janë në kundërshtim me Kur’anin a.sh. dhe me sunnetin e Muhammedit a.s. Ose, nëse edhe i di disa udhëzime të Kur’anit a.sh. dhe të sunnetit të Muhammedit a.s., mirëpo në to reagon me këto fjalë: “Kjo nuk ka të bëjë me mua, unë këtë nuk e pranoj” ose “të parët e mi ndryshe kanë punuar, e unë kështu nuk mund të punoj” ose “tradita botërore kështu nuk thotë, e unë do ta pasoj vetëm atë”. Një person i tillë që e quan veten musliman është gënjeshtar.

DETYRA E MUSLIMANIT

Kur thoni fjalën: *La ilahe il-lall-llah Muhammedur-Resulull-llah*, nënkuptohet se për ju ligj i vetëm është ligji i All-llahut xh.sh. Sundues i vetëm për ju është All-llahu xh.sh. Prijësi juaj është All-llahu xh.sh., ju duhet nderuar vetëm All-llahun xh.sh. dhe vetëm ajo që është e vërtetë dhe e lejuar në Librin e Tij është e vërtetë dhe e lejuar për ju. Kjo do të thotë se ia keni dhuruar All-

llahut xh.sh. pavarësinë tuaj në atë çast kur jeni bërë musliman. Njëherazi, humbni të drejtën për të thënë: “Mendimi im është kështu, traditat në botë janë kështu, traditat familjare janë kështu, ky zotëri dhe ky person i shquar më porositë kështu”. Nuk ka më arsyetime të tilla para fjalës së All-llahut xh.sh. dhe para sunnetit të Muhammedit a.s. Tash detyrë juaj është që çdo send ta vlerësoni në dritë të Kur’anit a.sh. dhe të sunnetit. Jeni të detyruar të pranoni çdo gjë që është në pëlqim me to, e çdo gjë që është në kundërshtim me to duhet ta hudhni poshtë, pa marrë parasysh urdhërin apo shprehinë e dikujt. Do të ishte në kundërshtim me parimet Islame që veten ta quash musliman, ndërsa të nderosh mendimet e dikujt tjetër, traditat botërore ose fjalët e veprat e dikujt pos Kur’anit a.sh. dhe sunnetit. Ashtu siç nuk mund i verbëri të thotë se ka sy ose ai që s’ka hundë të thotë se ka hundë, ashtu edhe një person nuk mund ta konsiderojë veten musliman nëse refuzon t’i rregullojë të gjitha punët e tij në përputhje me udhëzimet e Kur’anit dhe sunnetit, dhe nëse nuk i lë anash dëshirat e tij, traditat botërore dhe thënie të traditat e kujtdo qoftë për nder të All-llahut xh.sh. dhe për nder të Muhammedit a.s.

Atë që nuk dëshiron të jetë musliman, nuk mund ta bësh me dhunë. Është i lirë të zgjedhë cilëndo fe, të quhet me cilindo emër që dëshiron. Mirëpo, nëse dikush e quan veten musliman duhet medoemos të kuptojë se musliman mund të jetë derisa është në kufijtë e Islamit. Ligjet e Islamit janë: të pranohet fjala e All-llahut xh.sh. dhe sunneti i Muhammedit a.s. si masë matëse e së vërtetës dhe drejtësisë dhe të konsiderohet e gabueshme dhe e shëmtueshme çdo gjë që është në kundërshtim me te. Kush vepron brenda këtyre kufijve është musliman, e kush i kalon këta kufij është i përjashtuar nga Islami. Nëse edhe më tej e quan veten musliman, ai e gënjen veten dhe botën: “Prandaj, mos u frikësoni nga njerëzit, vetëm Mua të më frikësoheni dhe mos i

ndërroni argumentet e Mia për pak send. E kush nuk gjykon me atë që e zbriti All-llahu, ata janë mohues (kafira).” (Kur’ani; 5:44)

KUPTIMI I FJALËS SË MIRË (KELIME TAJJIBE-S) VËLLEZËR MUSLIMANË!

E dini se një njeri bëhet musliman me shprehjen (recitim) e thënies, e cila është shumë e madhe edhe pse përbëhet vetëm prej disa fjalëve: *La ilahe il-lall-llab Mubammedur-Resulull-llab*. (Nuk ka Zot tjetër pos All-llahut, Muhammedi është pejgamber i All-llahut). Me shprehjen e këtyre fjalëve, të cilat quhen kelime, njeriu pëson ndryshime të rëndësishme. Prej kafirit bëhet musliman. Më parë ka qenë i papastër e tash është i pastër. Më parë me të ka qenë i hidhëruar All-llahu xh.sh. e tash është i dashuri i Tij. Më parë ishte i përcaktuar për xhehenem e tash iu hapën dyert e xhennetit. Mirëpo, procesi nuk mbaron këtu. Në pëlqim me kelimen ndodh një ndërrim i madh ndërmjet njeriut dhe njeriut. Ata që e shprehin kelimen bashkohen në një bashkësi, ndërsa ata, që e refuzojnë këtë mësim (shprehje), i takojnë bashkësisë tjetër. Nëse prindi e shpreh këtë fjalë, kurse djali e refuzon një gjë të tillë, atëherë prindi më nuk është prind e djali më nuk është djalë. Djali nuk do ta trashëgojë pasurinë e prindit. Bile edhe nëna e motra e tij do të nderojnë perdahin dhe do të qëndrojnë larg tij. (Edhe pse sheriatu nuk përcakton për nënën dhe motrën muslimane të izoloohen nga djali dhe vëllai kafir, mirëpo muslimanet me besim të fortë, zakonisht, ndahen nga djemtë ose vëllezërit e tillë). Nëse ndonjë person i paudhëzuar, i cili e mëson kelimen,

martohet me ndonjë vajzë nga ndonjë familje muslimane, ai dhe fëmijët e tij do të trashëgojnë pasurinë e asaj familjeje, por nëse djali i lindur në familje muslimane refuzon besimin në kelimen, i humb të gjitha lidhjet me atë familje. Kjo tregon se kelimeja është fenomen që i bashkon dy të huaj, kurse i ndanë dy të afërt. Fuqia e kelimes është aq e madhe saqë i ndërpret marrëdhëniet farefisnore në bazë të gjakut.

PËRSE DALLIM KAQ I MADH?

Merrni parasysh pyetjen, përse ekziston dallim kaq i madh ndërmjet një njeriu dhe një njeriu tjetër? Çka ka në kelime? Përbëhet prej disa shkronjave (K,E,L,I,M,E). Vallë nëse i bashkojmë dhe i shprehim kështu të bashkuara do të ndikojnë aq shumë saqë të shkaktojnë ndryshim aq të madh te njeriu? Vallë kjo fjalë e vogël ka fuqi të bën dallime të mëdha sa qielli dhe toka? Vëllezër të mi! Nëse mendoni pak më thellë, do të vini në përfundim se vetëm hapja e gojës dhe shprehja e disa rrokjeve nuk prodhojnë vepër kaq të madhe.

Adhuresit e idhujve pa dyshim besojnë se me recitimin e “mantres” mund ta lëvizin malin, ta ndajnë tokën dhe të krijojnë burim edhe pse askush nuk e di kuptimin e “mantres”. (Mantra është fjalë sanskrite, që do të thotë: “armë e të menduarit”, që përdoret në Vedizëm si formulë e përbërë nga disa rrokje ose fjalë, ose nga një fjalë e thjeshtë). Kjo ndodh ngase besojnë se e gjithë fuqia qëndron në ato fjalë. Nuk hapen dyert e mrekullisë sapo të shprehen fjalët. Jo në Islam. Në Islam më kryesor është kuptimi. Efekti i fjalëve qëndron në domethënien dhe kuptimin e tyre.

Nëse ato fjalë nuk kanë kuptim dhe nëse nuk burojnë nga thellësia e zemrës, nëse nuk prodhojnë ndryshime të mëdha në mendimet tuaja, në kuptimet tuaja morale dhe në veprat tuaja, atëherë shprehja e këtyre fjalëve është e pa efekt.

Dëshiroj ta shpjegoj këtë me një shembull të thjeshtë: të themi se dridheni nga të ftohtit dhe filloni të thërrisni pambuk, mbulesë, pambuk mbulesë - të ftohtit nuk do të zvogëlohet, po edhe nëse i përsëritni këto fjalë tërë natën e i përsëritni me miliona herë në trespah. Natyrisht nëse keni mbulesë të pambukut dhe e mbulonit trupin, të ftohtit nuk do ta ndjeni. Ose të themi se ndjeni etje dhe tërë ditën thërritni: ujë, ujë, etja juaj asnjëherë nuk do të shuhet. Por, natyrisht, nëse merrni ndonjë gotë me ujë dhe e pini, etja juaj do të shuhet. Ose, nëse jeni të sëmurë nga gripi dhe keni zjarrmi, e pandërprerë i përmendni emrat e atyre barërave, të cilat nëse i pini do të shëroheni. Mirëpo, normalisht, kështu asnjëherë nuk do të shëroheni, por do të shëroheni atëherë kur do t'i përdorni këto barëra e gripi e zjarrmia do të kalojnë. Pikërisht e njëjta gjë është edhe me shprehjen e kelimes. Shprehja e thjeshtë e gjashtë-shtatë fjalëve nuk mund të sjell ndryshim aq të madh siç është transformimi i kafirit në musliman, i personit të papastër në person të pastër, i personit të mallkuar në person të bekuar ose i personit të përgatitur për në xhehenem në person të përgatitur për në xhennet. Një ndryshim i tillë është i mundur kur të kuptoni domethënien e këtyre fjalëve dhe kur të mundoheni që të depërtojnë në vetëdijen tuaj. Nëse i shprehni duke ditur domethënien e tyre, në plotësi do të kuptoni madhërinë e veprave që i bëni para All-llahut xh.sh. dhe para botës, si dhe shkallën e përgjegjësisë që bie mbi ju si rezultat i dëshmisë. Pasi të kuptoni thellësinë e kësaj dëshmie, ajo duhet t'ua kontrollojë jetën në tërësi, që do të thotë se asnjë ide tjetër që është në kundërshtim me kelimen nuk guxon të paraqitet në mendimet tuaja. Atëherë duhet të vendosni përgjithmonë se çdo gjë që është në kundërshtim me kelimen është e ga-

bueshme, kurse vetëm kelimeja është e vërtetë. Në këtë rast kelimeja duhet të ketë pushtetin suprem në të gjitha veprat dhe ndodhitë e jetës suaj. Me pranimin e kelimes nuk jeni më të lirë, si kafirat, të veproni çka të dëshironi. Tash, të lidhur me kelimen, medoemos duhet t'i pasoni udhëzimet dhe urdhërat e saja dhe të largoheni nga ajo që ndalon. Nëse në këtë mënyrë e shprehni kelimen, bëheni musliman i vërtetë me plotë kuptimin e fjalës. Nëpërmjet këtij procesi vihet deri te dallimi aq i madh ndërmjet një njeriu dhe një njeriu tjetër.

KUPTIMI I KELIMES

Më lejoni që t'ua sqarojë kuptimin e kelimes dhe atë që e shpreh njeriu me rastin e dëshmisë dhe çfarë detyrash bien mbi atë njeri pasi që ta shprehë kelimen. Kelime do të thotë se nuk ekziston Zot tjetër pos All-llahut xh.sh. dhe se Muhammedi a.s. është Pejgamber i All-llahut xh.sh. Fjala “All-llah” që e vëreni në këtë kelime do të thotë Zot. Kjo Qenie është Zot, i Cili është Mësues, Krijues, Mbikëqyrës dhe Perëndi që i dëgjon lutjet tona dhe i pranon dhe i Cili është i denjë për nderim. Nëse thoni *La ilabe il-lall-llah*, do të thotë se kjo fjalë nuk është krijuar pa fuqi krijuese të Zotit xh.sh., e as që është çështje që mund të ketë shumë zota. Në realitet, kjo fjalë e ka Zotin e vet, i cili është Një i Vetëm dhe s'ka qenie tjetër pos Tij që ka fuqi hyjnore. Me shprehjen e kësaj fjale kuptohet edhe ajo se Zoti, të cilin e besojmë, është Zot i gjithë botës. Çdo gjë, qoftë juaja apo e botës, është e Tij. Ai është Krijues dhe Mirëmbajtës. Jeta dhe vdekja janë nën urdhërin e Tij. E mira dhe e keqja janë, po ashtu, prej Tij. Çdo send që është marrë prej ndokujt, është vepër e urdhërit të Tij. Vetëm nga Ai duhet frikësuar dhe vetëm Ate duhet lutur për plotësimin e

dëshirave dhe të nevojave tona. Vetëm Atij duhet t'i përulemi dhe vetëm Ai meriton të adhurohet dhe të nderohet. Ne jemi robër të Tij dhe nuk kemi Zot e Sundues tjetër pos Tij. Detyrë jona është t'u përulemi urdhërave të Tij dhe t'i nderojmë ligjet e Tij.

MARRËVESHJE ME ALL-LLAHUN XH.SH.

Me rastin e shprehjes së kelimes *La ilabe il-lall-llab*, i japim besën All-llahut xh.sh. dhe me këtë rast gjithë botën e kemi dëshmitarë. Nëse e theni besën që e keni dhënë, duart dhe këmbët tuaja, qimja më e vogël në trupin tuaj dhe çdo pjesë e tokës dhe qiellit para të cilëve jeni betuar rrejshëm, do të dëshmojnë kundër jush në gjyqin e All-llahut xh.sh., kur do të gjendeni në situatë pa rrugëdalje dhe kur do të mbeteni pa asnjë dëshmitarë në anën tuaj. Nuk do të ketë as avokat e as mbrojtës që do të mund të ju mbrojnë. Në realitet, avokatët dhe mbrojtësit, të cilët zakonisht luajnë me ligjin në gjyqet e kësaj bote, do të jenë para gjyqit të All-llahut xh.sh. sikur edhe ju, pa rrugëdalje. Ky gjyq nuk është i tillë që të ju lirojë në bazë të argumenteve të rrejshme, dëshmime të rrejshme, dokumenteve të rrejshme etj. Ju mund ta fshihni krimin para policisë së kësaj bote, mirëpo këtë gjë nuk mund ta bëni para policisë së All-llahut xh.sh.. Policinë e kësaj bote mund ta korruptosh, mirëpo policinë e All-llahut xh.sh. nuk mundesh. Dëshmitari në këtë botë mund të dëshmojë rrejshëm, mirëpo dëshmitarët e All-llahut xh.sh. flasin vetëm drejt. Sunduesit e kësaj bote mund të bëjnë padrejtësi, mirëpo All-llahu xh.sh. nuk është Sundimtar që bën padrejtësi. Pastaj, nuk mund të ikish nga burgu i All-llahut xh.sh. Është marri e madhe, në realitet, marria më e madhe është t'i përбетohesh All-llahut xh.sh. rrejshëm. Kur të besatoheni për ndonjë punë,

mendoni mirë dhe atë besatim çone në vend me drojë, sepse askush nuk ju detyron të dëshmoni, sepse dëshmitë e zbrazëta dhe boshe janë të padobishme dhe të kota.

PRANIMI I UDHËHEQJES SË PEJGAMBERIT A.S.

Pas pjesës së parë *La ilabe il-lall-llab*, e thoni edhe pjesën e dytë të kelimes - *Mubammedur-Resulull-llab*, që do të thotë se e pranoni Muhammedin a.s. si Pejgamber të All-llahut xh.sh., përmes të cilit All-llahu xh.sh. e ka shpallur ligjin e Tij. Pasi që pranuar All-llahun xh.sh. si Zot tonin dhe si Udhëheqës suprem, medoemos duhet ditur cilët janë urdhërat e Tij, cilën rrugë duhet pasuar për të arritur kënaqësinë e Tij dhe nga cila rrugë duhet larguar për të ikur nga hidhërimi i Tij. Cili duhet të jetë ligji ynë jetësor, që duhet ta pasojmë në mënyrë që të fitojmë faljen e Tij dhe për kundërvajtjen e të cilit do të fitonim dënimin e Tij? All-llahu xh.sh. e zgjodhi Muhammedin a.s. si Pejgamber të Vetin për të na sqaruar këto gjëra, dhe e shpalli Librin e Tij përmes tij. Muhammedi a.s. jetën e vet e rregulloi në pajtim me urdhërat e All-llahut xh.sh., dhe me këtë u ka dhënë shembull muslimanëve se si duhet udhëhequr jetën e tyre. Prandaj kur thoni *Mubammedur-Resulull-llab*, detyroheni të pasoni ligjin dhe sistemin që e ka treguar ai dhe të largoheni nga rrugët, që janë në kundërshtim me to. Nëse pas kësaj dëshmie e hudhni poshtë ligjin e Muhammedit a.s. dhe pasoni ligjin që momentalisht mbisundon në botë, do të bëheni njeriu më gënjeshtar dhe më i pandershëm nga të gjithë të tjerët, pasi që Islami në bazë të dëshmisë thekson se ligji i Muhammedit a.s. është ligj i vetëm që duhet ta pasoni. Me ndihmën e kësaj dëshmie jeni bërë vëlla i muslimanëve, keni trashëguar pasurinë e prindit tuaj musliman, jeni martuar me

muslimane, fëmijët tuaj janë bërë trashëgues tuaj të rregullt, keni siguruar të drejtën për ndihmë nga të gjithë muslimanët, të cilët e japin zekatin dhe të cilët kanë përgjegjësi për mbrojtjen tuaj. Por, nëse e theni besën e dhënë, keni bërë veprën më të ligë në botë. A ka tradhti më të madhe se të thyesh besën e dhënë? Nëse e dini kuptimin e kelimes *La ilabe il-lall-llab* dhe e ndjeni besimin në te me plotë kuptimin e saj, atëherë, pra gjithsesi duhet të punoni në pajtim me ligjin e All-llahut xh.sh. Nëse ndokush mendon se është lehtë t'i thyesh ligjet e All-llahut xh.sh., me qenë se policia, ushtria, gjyqi dhe burgu i All-llahut xh.sh. nuk shihen, kurse është rëndë t'i thyesh ligjet e pushtetit, pasi që e ka policinë, ushtrinë, gjyqin dhe burgun e vet, unë për një person të tillë lirisht them se ka dhënë dëshmi të rrejshme. Ai, në realitet, ka dashur ta mashtrrojë All-llahun xh.sh., kurse përkundrazi e ka mashtruar tërë botën, të gjithë muslimanët dhe vetveten.

PËRGJEGJËSITË QË BUROJNË NGA DËSHMIA

Vëllezër të dashur! Pak më parë ju shpjegova kuptimin e kelimes. Në këtë kapitull dëshiroj të ju tërheq vërejtjen në një aspekt tjetër. Ju e pranoni All-llahun xh.sh. si Udhëheqës tuajin, si dhe Udhëheqës të gjithçkafit. Çka do të thotë kjo? Kjo do të thotë se jeta juaj nuk është pronë juaja, por është pronë e All-llahut xh.sh.. Duart tuaja, sytë tuaj, veshët, si dhe çdo pjesë e trupit tuaj nuk është juaja. Tokën që e punoni, kafshët që u shërbejnë, të mirat dhe pasuria nga e cila jetoni - nuk janë pronë juaj. Çdo send, qoftë edhe më i vogël, i takon vetëm All-llahut xh.sh. dhe të gjitha këto të mira juve ju janë dhënë në besë. Kur t'i shikoni e t'i kuptoni këto fakte, si mund të thoni atëherë: jeta është imja, trupi është imi, pasuria është imja, kjo e ajo është imja? Është e

palogjikshme të pohoni se ndokush tjetër është pronar i pasurisë suaj, duke dëshiruar që ta mbronni atë. Nëse me sinqeritet besoni se All-llahu xh.sh. është pronar i të gjithë këtyre sendeve, atëherë automatikisht dy sende bëhen detyrë juaja. E para, nëse All-llahu xh.sh. është Pronar dhe nëse Ai ua ka besuar të mirat e Tij, atëherë këto të mira duhet t'i shfrytëzoni në pajtim me udhëzimet e Tij. Nëse i shfrytëzoni në kundërshtim me dëshirën e Tij, do të thotë se po e tradhtoni besën e dhënë. Ju nuk guxoni të lëvizni as këmbën e as dorën në kundërshtim me ligjin e Tij. Nuk guxoni të futni në gojë asgjë që është në kundërshtim me ligjin e Tij. Nuk posedoni kurrfarë të drejte mbi tokën dhe pronat tjera, nëse ajo është në kundërshtim me dëshirën e All-llahut xh.sh.. Gruaja juaj dhe fëmijët tuaj, për të cilët thoni se janë të juajit, të juaj janë vetëm për shkak se ua ka dhënë Zoti xh.sh.. Për këtë shkak edhe me ta nuk guxoni të veproni ashtu si të doni ju, por në pajtim me udhëzimet e All-llahut xh.sh.. Nëse punoni në kundërshtim me urdhërat e Tij, pozita juaj do të jetë pozitë uzurpatori. Sikur që i quani të pandershëm ata njerëz që e përvetësojnë tokën e huaj edhe ju do të jeni të pandershëm nëse dhuratat e All-llahut xh.sh. i konsideroni si pronë tuajën dhe i trajtoni në pajtim me dëshirat tuaja, ose në pajtim me dëshirat e ndokujt tjetër pos All-llahut xh.sh.. Nëse përjetoni humbje duke punuar në pajtim me ligjin e All-llahut xh.sh., le të bëhet ashtu. Asnjëherë nuk guxoni ta vajtoni jetën e humbur, këmbët e duart e thyera, fëmijët e humbur dhe pasurinë e shkatërruar. Përse të jeni të dëshpëruar? Nëse vetë Pronari dëshiron humbjen e tyre, ka të drejtë të veprojë ashtu si të dëshirojë. Por, natyrisht, nëse veproni në kundërshtim me dëshirën e All-llahut xh.sh. dhe përjetoni humbje, në këtë rast pa dyshim do të jeni ju fajtor, për shkak se keni shkatërruar pasurinë e huaj. Ju nuk jeni të zotët e shpirtit tuaj. Por, nëse e jepni jetën tuaj në pëlqim me dëshirën e All-llahut xh.sh., keni plotësuar detyrën tuaj ndaj Tij, e nëse e humbni jetën duke vepruar në kundërshtim me dëshirën e Tij, keni bërë vepër me të cilën keni treguar mosnderimin tuaj ndaj Tij.

ME PRANIMIN E ISLAMIT NUK I BËHET SHËRBIM ALL-LLAHUT XH.SH.

Pra, nëse ndonjë send, të cilën ua ka dhuruar All-llahu xh.sh. e përdorni në rrugë të Tij, nuk i bëni shërbim askujt - as Zotit xh.sh. e as ndokujt tjetër. Nëse me kërkesën e Tij jeni larguar nga ndonjë send ose keni bërë ndonjë shërbim, ose bile edhe keni sakrifikuar jetën tuaj, që ju vlenë shumë, nuk i keni bërë shërbim All-llahut xh.sh.. Kjo do të thotë se vetëm jeni përpjekur të lirohemi nga shërbimi që ju ka bërë All-llahu xh.sh. juve. A është kjo vepër për të cilën duhet të krenohemi dhe të bëhemi me famë, në të cilën mënyrë shprehet falënderimi njerëzor? Mbane mend, muslimani asnjëherë nuk ndihet krenar për zbatimin e detyrave apo për shërbimin që ia bën Zotit xh.sh.. Përkundrazi, ai edhe më tepër e tregon përvullësinë e tij. Krenaria e shkatërron të mirën. Cilido që kërkon lavd ose e bën ndonjë vepër për ta lavdëruar ndokush, e humb të drejtën e tij për çfarëdo qoftë shpërblimi nga All-llahu xh.sh., për shkak se shpërblimin, të cilin e ka kërkuar për punën e tij në këtë botë, tani veç e ka fituar.

DHURATA E ALL-LLAHUT XH.SH. DHE SJELLJA JONË

Vëllezër! Shikoni shërbimin e Zotit xh.sh. Ai merr nga ju sendet që i takojnë vetëm Atij dhe edhe më tej thotë: “Unë e kam marrë këtë send prej jush dhe Unë do t’ju paguaj për këtë”. All-llahu Ekber (All-llahu është më i Madhi). Sa mirësi e madhe. Kur’ani a.sh. po flet: “All-llahu bleu prej

besimtarëve shpirtrat dhe pasurinë e tyre me xhennet. Luftojnë në rrugën e All-llahut xh.sh., mbysin dhe mbyten. (All-llahu dha) premtimin të cilin e vërtetoi në Tevrat, Inxhil e Kur'an. E kush është më zbatues i sigurt i premtimit të vet se All-llahu? Pra gëzonju tregtisë që e bëtë me Të. Ky është sukses i madh!” (Kur’ani; 9:111)

Kjo është dhurata e All-llahut xh.sh. për ju. Por shikone sjelljen tuaj. Ua shitni tjerëve sendet që ua ka dhënë All-llahu xh.sh. dhe I cili i ka blerë nga ju pa pagesë. E kjo shitje është bërë për kompensim të pavlefshëm. Blerësit e marrin punën tuaj në kundërshtim me dëshirën e Zotit xh.sh., e ju u shërbeni duke menduar se janë furnizuesit tuaj. Ua shitni trurin tuaj, këmbët e duart tuaja, fuqinë e trupit tuaj dhe çdo send që armiqtë e All-llahut xh.sh. dëshirojnë të blejnë nga ju. A mund të ketë prishje morale më të madhe se kjo? T’i shesësh sendet e shitura është krim juridik e moral. Fajtorët për këto krime u janë besnike tradhtive dhe mashtrimeve në këtë botë. A mendoni se në gjyqin e All-llahut xh.sh. nuk do të ngritet akuzë kundër këtyre njerëzve?

FJALA E MIRË DHE FJALA E KEQE (KELIME TAJJIBE DHE KELIME HABITHE) VËLLEZËR MUSLIMANË!

Në ligjëratën e fundit ju sqarova pak për kelimen tajjibe (fjalën e mirë ose dëshminë). Tash do t’ju flas pak më tepër për kelimen, për shkak se është themel i Islamit. Njeriu e arrinë Islamin me fuqinë e kelimes (dëshmisë) dhe askush nuk mund të bëhet musliman i vërtetë nëse nuk e ka

kuptuar kelimen në tërësi dhe nëse nuk vepron në pajtim me të. All-llahu xh.sh. kështu e ka treguar kelimen në Kur'an: "A nuk ke kuptuar se si All-llahu bëri shembull: fjalën e mirë si pema e mirë që rrënjët e saj janë thellë (në tokë) e degët e saj janë lartë, e që me vullnetin e Zotit, ajo e jep frytin e vet në çdo kohë. All-llahu pra u parashtron njerëzve shembuj ashtu që ata të mendojnë. Dhe shembulli i fjalës së keqe si një pemë e keqe që është shkukur mbi tokë e që nuk ka të qëndruar. All-llahu forcon ata, që besuan në fjalën e fortë (të mirë) në jetën e kësaj bote e edhe në botën tjetër, ndërsa mizorët All-llahu i bën të humbur. All-llahu punon çka të dojë". (Kur'ani; 14:24-27)

Kjo do të thotë se kelimeja tajjibe është si një dru i përforcuar mirë me rrënjë në tokë, me degë të përhapura gjer në qiell, e cila pandërprerë jep fryte të atilla çfarë ka urdhëruar Zoti xh.sh. Përkundër kësaj qëndron kelimeja habithe (fjala e keqe - dëshmia se s'ka Zot), e kjo do të thotë: besim i keq dhe fjalë e rrejshme, që i përngjet një bime të vetëmbimur me fryte të dobta, e cila rritet vetëm në sipërfaqe të tokës, dhe e cila mund të shkulet me një lëvizje të vogël, pasi që nuk është e përforcuar mirë me rrënjët në tokë.

Ky është një shembull aq fantastik, saqë sikur ta kuptonit në thellësi do të nxirrnit një këshillë të mirë. Shihni! Përpara i keni dy llojet e drunjve. Njëri është druri mango. I përforcuar mirë në tokë, me shtat të lartë, me degë të degëzuara gjerë dhe me fryte të mira. Përse ky dru merr një pozitë të tillë? Shkaku qëndron në atë se bërthama e frytit ka pasur fuqi. Ka pasur të drejtë të bëhet dru. Kjo e drejtë ka qenë e vërtetë, saqë çdo pjesë e mundshme, dielli, toka, uji, nxehtësia, ftohtësia,... e kanë kuptuar këtë të drejtë dhe i është dhënë çdo send që është kërkuar nga këto. Dhe kështu me fuqinë e virtyteve të tij është rritur dhe është bërë dru. E me dhënien e fryteve të ëmbla, ka vërtetuar meritën e tij për t'u bërë dru i madh dhe se ndihma që ia kanë dhënë toka, uji,

dielli, etj., ka qenë me vend. Në realitet ka qenë detyrë e tyre, për shkak se fuqia, të cilën e posedojnë toka, uji, dielli dhe elementet e tjera të nevojshme për ushqim, për zhvillim dhe për pjekje, janë të krijuara edhe për ta ndihmuar drurin me fryte të mira.

Përkundër kësaj, ekzistojnë kaçubat, shelgjet dhe bimët e egra. Çfarë forme kanë? Kanë rrënjë të vogla, të cilat edhe një fëmijë mund t'i shkulë. Të but dhe të lakueshme saqë dridhen në çdo puih të erës. Nëse i preknë do të ju shpojnë gjembat e tyre. Nëse i shijoni do të jua prishin shijen. All-llahu e di se sa bimë të tilla mbijnë në ditë dhe sa prej tyre shkulen. Vallë përse këto janë në këtë gjendje? Për shkak se këto nuk kanë vlerën dhe fuqinë, që e posedon druri mango. Kur të përkryhet druri me fryte të mëdha, toka lodhet nga papunësia e rrejshme dhe i lejon këto kaçuba të rriten. Pak ndihmë u ofron ajri, pak uji, kurse asnjë element i tokës e i qiellit nuk është i gatshëm të pranojë të drejtën e ekzistencës së këtyre bimëve. Për këtë shkak toka nuk u lejon t'i përhapin rrënjët në hapësirën e saj, uji nuk dëshiron t'u japë ushqim me gjithë zemër, kurse ajri refuzon t'i bëjë të fuqishme. E kur këto bimë të çoroditura rriten, me një ndihmë aq të varfër, duke pasur shije të keqe, gjemba dhe komponente të helmit, kjo nuk argumenton asnjë send tjetër, pos mosdëshirën e tokës dhe qiellit për të ndihmuar. Nga kjo del se edhe kjo ekzistencë minimale është tepër për to.

Mbani mend këta dy shembuj dhe mendoni për dallimin e kelime tajjibes dhe kelime habithes.

Ç'ËSHTË KELIMEJA TAJJIBE (FJALA E MIRË)?

Fjala e mirë (kelimeja tajjibe) është kulmi i së vërtetës. Aq është e vërtetë saqë është e pamundur të ekzistojë diç më gjeniale se kjo: “Zot i gjithësisë është All-llahu xh.sh.”. Të gjitha krijesat në tokë dhe në qiell dëshmojnë këtë vërtetësi. Këto qenie njerëzore, këto kafshë, këta drunj, këta gurë, këto grimca të rërës, ky diell i nxehtë, këta lumenj,... kush i krijoi, a ekziston ndonjë imtësi e vogël që s’është e krijuar nga All-llahu xh.sh., që mund të jetojë me dëshirën e ndokujt tjetër, pos All-llahut xh.sh.. E mbase tërë gjithësinë e ka krijuar All-llahu xh.sh. dhe ekzistenca e saj varet nga mëshira e Tij dhe vetë All-llahu xh.sh. është Sundues dhe Zot i saj, andaj kur tash dëshmoni: “Në këtë botë nuk ekziston askush tjetër që posedon pushtetin dhe fuqinë supreme, pos All-llahut xh.sh.”, të gjitha krijesat që janë në qiell e në tokë do të thonë: “E keni thënë të vërtetën absolute”. Ne të gjithë e dimë vërtetësinë e këtij parimi. Kur t’i faleni Atij, çdo gjë në botë falet me ju, sepse të gjitha këto sende i përuhen Atij. Kur t’i dëgjoni urdherat e Tij, gjithçka në këtë botë do të dëgjojë të njëjtin Zot. Kur të ecni në rrugën e Tij, nuk do të jeni vetëm. Në realitet, ajo ushtri e panumërt e mbarë botës do të ju përcjellë, për shkak se prej diellit e deri në pjesën më të imët të tokës, të gjithë e pasojnë rrugën e Tij. Kur të mbështeteni në Te, nuk do të mbështeteni në fuqi të vogël, por në një fuqi gjigante, që është Zot i gjithçkafit në tokë dhe në qiell. Thënë shkurt, kur keni parasysh këtë të vërtetë, do të kuptoni se të gjitha fuqitë e tokës dhe të qiellit do ta përmbajnë një person që e vërteton besimin e tij në kelimen tajjibe (fjalën e mirë) dhe i cili e formulon jetën e tij në pajtim me te. Ky person do të vazhdojë lulëzimin e tij nga kjo botë e deri në botën tjetër. Kjo është pikërisht ajo që ka thënë All-llahu i Plotfuqishëm, se kjo fjalë është

sikurse druri me rrënjë të përforuara fortë në tokë dhe me degë të shpërndara (të përhapura) nëpër qiell duke bërë fryte vetëm me urdhërin e All-llahut xh.sh.

Ç'ËSHTË KELIMEJA HABITHE (FJALA E KEQE)?

Përkundër të parës e kemi kelimen habithe (fjalën e keqe). Ç'do të thotë kjo? Kjo do të thotë se nuk ekziston Zot, ose ka shumë zota, ose që ekziston ndokush tjetër pos All-llahut xh.sh., që ka fuqi hyjnore. Mendoni! A mund të ketë situatë më të pabazë? A ka ndokush në botë mundësi të vërtetojë një gjë të tillë? Jobsimtari thotë se nuk ka Zot, mirëpo gjithçka në këtë botë dhe në qiell tregojnë dhe vërtetojnë se ky person po gënjen, për shkak se ky bashkë me të gjitha këto krijesa është krijuar nga All-llahu xh.sh., dhe i njëjti Zot xh.sh. ia ka dhënë gjuhën me të cilën ai flet prap e marë. Politeistët (mushrikët) thonë se fuqitë tjera janë bashkëpunëtorë të autoritetit të Zotit xh.sh., se edhe ato janë mirëmbajtës dhe zotëri, se edhe ato posedojnë fuqi që të ndryshojnë dhe të përcaktojnë kaderin e All-llahut xh.sh., se edhe ato mund të dëgjojnë lutjet e njerëzve dhe t'u plotësojnë dëshirat, se edhe ato meritojnë t'u frikësohesh e t'u mbështetesh, se edhe urdhëri i tyre vlen në këtë botë të Zotit xh.sh., se edhe ligjet e tyre duhet respektuar pranë ligjeve të All-llahut xh.sh.. Si përgjigje në këto thënie të tyre është refuzimi i këtyre kërkesave si gënjeshtër absolute dhe si kundërshti e plotë e së vërtetës. Tash, mendoni dhe më thuani si mundet një person që beson në kelimen habithe, dhe i cili e udhëheqë jetën e tij në pajtim me të, të përparojë në këtë dhe në botën e ardhshme? All-llahu xh.sh. me mëshirën e Tij u ka dhënë lehtësi njerëzve të tillë dhe u ka premtuar mjete për jetë. Për këtë shkak fuqitë e tokës dhe të qiellit do t'i ushqejnë edhe

këta njerëz, pikërisht sikur u japin ushqim kaçubave dhe bimëve të egra, por asgjë në këtë botë nuk e ndien veten si të detyruar, e as që do t'u japë fuqinë e duhur. Këta njerëz do të jetojnë sikur drunjtë e vetmbimur që i përmendëm pak më parë.

DALLIMI NË REZULTAT

Dallimi i njëjtë është vërtetuar ndërmjet fryteve të këtyre dy llojeve. Saherë që kelimeja tajjibe të sjellë fryte, ato do të jenë të ëmbla dhe të dobishme. Do të përforcojnë rehatinë në botë. Do të mbisundon e mira, e vërteta dhe drejtësia në botë, gjë kjo që me siguri do t'i kënaq njerëzit. Në anën tjetër, sa më tepër rritet kelimeja habithe, aq më tepër degë me gjemba do të bën, do të jep më shumë fryte të hidhura dhe të pashije. Helmi do të qarkullojë në venët e kësaj bime.

Me sytë tuaj mund të shihni se ç'ndodh atje ku kufri, shirku dhe pabesimi mbisundon. Njeriu është i gatshëm t'i copëtojë shokët e vet. Mjete të ndryshme janë në rrugë për të shkatërruar vendbanim pas vendbanimi. Gazet helmuese prodhohen me shumicë. Një komb shkatërron tjetrin. Të fuqishmit i shfrytëzojnë të dobët, vetëm e vetëm për t'ua marrë kafshatën e gojës. Të dobët janë të frikësuar me fuqinë e ushtrisë, policisë, me burgje e me vdekje. Janë të detyruar të durojnë shtypjen e më të fortëve. Dhe çfarë është pozita e këtyre kombeve? Morali i tyre është aq i prishur saqë edhe shejtani turpërohet prej tyre. Njerëzit bëjnë vepra, të cilat as kafshët nuk i bëjnë. Nënati i mbysin fëmijët me duart e veta, vetëm e vetëm mos t'ua prishin rehatinë. Burrat vetë ua lëshojnë gratë të tjerëve, që gratë e atyre të kenë mundësi të vijnë te këta. Hapen kampe

nudistike ku burra e gra shëtisin të zhveshur, mu si kafshët. Të pasurit, nëpërmjet kamatës, pinë gjakun e të varfërve, kurse pronarët thithin punën nga të varfërit sikur të kishin qenë robërit e tyre, sikur të ishin lindur për të shërbyer. Thënë shkurt, kudo që mbinë bimë nga kelimeja habithe, është plot gjemba dhe çfarëdo fryti të prodhojnë është i hidhur dhe helmues. Pas këtyre dy shembujve, All-llahu xh.sh. në fund thotë: “All-llahu i forcon ata, që besuan në fjalën e fortë (e mirë) në jetën e kësaj bote e edhe në botën tjetër, ndërsa mizorët All-llahu i bën të humbur”. (Kur’ani; 14:27)

Kjo do të thotë se All-llahu xh.sh. me betim të fortë, atyre që e përforcojnë besimin e tyre me kelimen tajjibe, do t’u dhurojë stabilitet dhe forcë në këtë botë dhe në botën e ardhshme; kurse përkundër këtyre, do të bëjë që të shkatërrohet i gjithë mundi i atyre kundërshtarëve, që besojnë në kelimen habithe. Ata asnjëherë nuk do të bëjnë punë të mbarë, e cila punë do t’u kishte sjellë rezultat të mirë në këtë botë dhe në botën e ardhshme.

PËRSE JANË NË FATKEQËSI PËRULËSIT E KELIMES?

Vëllezër! Dëgjuat dallimin ndërmjet kelimes tajjibe dhe kelimes habithe dhe rezultatet e tyre. Me siguri do të parashtroni pyetje: “Ne jemi përlës të kelimes tajjibe. Si bëhet që ne të mos jemi të fuqishëm, kurse kafirat të jenë të fuqishëm dhe të përparojnë?”. Për t’iu përgjigjur kësaj pyetjeje është detyrë e imja dhe unë do t’ua sqaroj duke u munduar që mos ta lë askë të pakënaqur me përgjigjen e dhënë dhe duke e pyetur veten me sinqeritet, a është përgjigjja me vend apo nuk

është! Në radhë të parë, pohimi juaj se jeni përlules të kelimes dhe nuk përparoni, nuk është i saktë. Besimi në kelimen nuk përbëhet vetëm nga të shprehurit e thjeshtë. Besimi medoemos duhet të dalë nga zemra dhe njëkohësisht të largojë nga zemra të gjitha besimet tjera që i kundërshtohen kësaj dhe asnjë vepër juaja mos të jetë në kundërshtim me besimin tuaj.

Vëllezër të mi! Për hir të All-llahut xh.sh. më thoni, a është situata me ju kështu? A nuk janë të pranishme te ju me qindra ide kufri dhe shirku, të cilat janë plotësisht në kundërshtim me kelimen? A nuk janë përlulur me miliona muslimanë para tjerëve, pos All-llahut xh.sh.? A nuk frikësohen muslimanët prej kafirave? A nuk varen muslimanët nga ndihma e të tjerëve? A nuk i pranojnë të tjerët si furnizues të tyre, pos All-llahut xh.sh.? A nuk largohen nga ligjet e All-llahut xh.sh., e në vend të tyre pasojnë ligje tjera? Vallë ata që e quajnë veten muslimanë, a nuk dëshmojnë vetë se nuk besojnë në sheriatin, pos nga tradita? A nuk ka në mesin tuaj prej atyre që nuk u vie rëndë të thyejnë ligjin e All-llahut xh.sh. vetëm për t'u pëlqyer të tjerëve? A nuk ka në mesin tuaj të tillë që frikësohen nga hidhërimi i kafirave, e aspak nuk dridhen para zjarrit të All-llahut xh.sh., dhe të tillë që janë të gatshëm të shkojnë kudo qoftë për ta fituar pëlqimin e kafirave, e janë të paaftë të veprojnë vepra, me të cilat do të jetë i kënaqur All-llahu xh.sh.. A nuk ka të tillë që mendojnë se pushteti i kafirit është i vërtetë, e që asnjëherë nuk ju bie ndërmend se ekziston pushteti i All-llahut xh.sh.? Nëse kjo është e vërtetë, si keni fytyrë të dëshmoni se jeni besimtarë të kelimes dhe prap nuk përparoni? Së pari, ju duhet të besoni në kelimen tajjibe me plot zemër dhe ta rregulloni jetën tuaj në pëlqim me qëllimet e kelimes. Nëse edhe në këtë rast ky dru me rrënjë të përforcuara mirë për toke, me degë të përhapura deri në qiell nuk rritet, atëherë, kërkoj falje nga All-llahu xh.sh., mund ta konsideroni Zotin tuaj gënjeshtar, i cili ju ka dhënë premtime të rrejshme.

A KORRIN SUKSES BESIMTARËT E KELIMES HABITHE?

Përsëri po theksoj, pohimi juaj se besimtarët e kelimes habithe po përparojnë në këtë botë, është plotësisht i gabuar. Këta njerëz asnjëherë më parë nuk kanë përparuar e as tash nuk përparojnë. Ju i vlerësoni duke parë pasurinë e tyre, sendet luksoze dhe shkëlqimin e jashtëm. Mirëpo, depërtoni pak në brendësinë e tyre dhe shikoni se sa kanë ata qetësi shpirtërore. Janë të ngarkuar me shkëlqimin e luksit, por në shpirtrat e tyre gjenden furra djegëse, të cilat asnjëherë nuk u japin qetësi. Mosrespektimi i ligjeve të All-llahut xh.sh. i shndërroi shtëpitë e tyre në xhehenem. Shikoni dhe shfletoni pak gazetatat, do të shihni se janë shpeshuar vrasjet dhe vetëvrasjet në Evropë e në Amerikë. Shkurorezimi është shumë i përhapur. Përqindja e lindjes dita-ditës po bie dhe po zvogëlohet. Sëmundjet venerike kanë shkatërruar jetën e miliona njerëzve. Bëhet luftë e hatashme për një copë bukë! Si ka krijuar luftë ndërmjet fisit të njëjtë zilia, shpirtligësia dhe armiqësia. Si ua ka bërë të hidhur jetën lakmia ndaj pasurisë! Edhe ato qytete të mëdha dhe fantastike që, për së largu, i përngjajnë xhennetit, përmbajnë me miliona njerëz të varfër. A edhe këtë e quani përparim? A ky është xhenneti, të cilin me aq zili e shikoni? Vëllezër të mi! Mbani mend se bota e All-llahut xh.sh. asnjëherë nuk mund të jetë e keqe. Në realitet, nuk ka kelime, pos kelimes tajiibe, të cilën duke e poseduar, mund të siguroni mirëqenie në këtë botë dhe famë në botën e ardhshme. Mund të hudhni shikimin në cilëndo anë, asnjëherë nuk do të keni rastin të gjeni diç që do të jetë në kundërshtim me të.

QËLLIMI I DEKLARIMIT TË BESIMIT NË KELIMEN TAJJIBE VËLLEZËR MUSLIMANË!

Në dy ligjëratat e mia të mëparshme ju shpjegova kuptimin e kelimes tajiibe. Sot do t'ua sqaroj të mirat që rrjedhin nga deklarimi i besimit në kelimen dhe përse është i domosdoshëm ky deklarim.

ÇDO VEPËR KA QËLLIM

E dini faktin se çdo vepër që punon njeriu e ka parasysh qëllimin dhe dobinë. Asnjëherë nuk punohet diç pa qëllim apo pa dobi. E pini ujin për të shuar etjen. Sikur të mos e shuante etjen uji, asnjëherë nuk do ta kishit pirë, për shkak se do të ishte vepër e pakuptimtë. Përse hani? Thjesht, për shkak se dëshironi të shuani urinë dhe të fitoni fuqi për jetë. Sikur ushqimi mos ta ndryshonte gjendjen tuaj, ju këtë vepër nuk do ta kishit bërë, sepse do ta konsideronit si vepër të kotë. Përse i merrni ilaçet kur jeni të sëmurë? Sepse dëshironi të shëroni sëmundjen dhe të bëheni të shëndoshë. Mirëpo, nëse pas marrjes së ilaçeve nuk ndjeni ndryshim në vete, do të përfundojmë se marrja e ilaçeve është e panevojshme. Përse punoni aq me zell kur e punoni tokën? Për të prodhuar grurë, pemë, perime etj. Mirëpo, nëse nuk mbinë asgjë, asnjëherë nuk do të mundoheshit aq shumë për ta lëvruar tokën, për të mbjellë farën dhe për të ujitur arën. Thënë shkurt, çfarëdo pune që të punoni në këtë botë, gjithmonë parasysh e keni qëllimin. Nëse arrini

rezultat do të thoni se ka qenë puna e mirë, e nëse nuk ka fitim, do të thoni se puna ka qenë e keqe.

QËLLIMI I SHPREHJES SË KELIMES

Ju lutem, të keni parasysh këtë që u thash dhe përgjigjuni pyetjeve që do t'ua parashtroj një nga një. Pyetja e parë dhe më me rëndësi është: përse shprehet kelimeja? Nëse dëshironi të përgjigjeni, përgjigje tjetër nuk ka, pos të thoni: qëllimi i saj është të tregojë kufirin ndërmjet kufirit dhe Islamit, ndërmjet kafirit dhe muslimanit. Tash pyes: çfarë kuptimi ka ky dallim? A do të thotë kjo se, nëse kafiri i ka dy sy, muslimani duhet t'i ketë katër, ose nëse kafiri ka një kokë, muslimani duhet t'i ketë dy? Ju do të ishit përgjigjur: jo, nuk është kjo domethënia e dallimit; kjo tregon se duhet të ekzistojë dallimi në rezultatin final ndërmjet muslimanit dhe kafirit. Qëllimi final i jetës së kafirit është të jetojë e të dëfrehet në këtë botë, duke u larguar nga mëshira e All-llahut xh.sh. edhe në botën e ardhshme, kurse qëllimi final i jetës së muslimanit është që me veprat e tij t'i afrohet mëshirës së All-llahut xh.sh. dhe All-llahu xh.sh. të jetë i kënaqur me të, e të jetë i shpërblyer në botën e ardhshme.

MOSSUKSESI DHE SUKSESI NË BOTËN E ARDHSHME

Do të kisha thënë se përgjigjja juaj është me vend. Mirëpo, më tregoni ç'është jeta në botën e ardhshme? Ç'do të thotë mossuksesi në atë botë? Ç'do të thotë të korrish sukses dhe të jeshë i shpërblyer atje? Përderisa nuk e sqarojmë dhe nuk e kuptojmë këtë nuk mund të ecim përpara.

Nuk ka nevojë të përgjigjeni, sepse përgjigjja tashmë është dhënë: ed-Dunja mezre'atu el-Ahire. (Kjo botë është toka përpunuese e botës së ardhshme). Kjo do të thotë se kjo botë dhe bota e ardhshme nuk janë dy sende të ndara, por janë proces i lidhur, fillimi i të cilit është kjo botë, kurse fundi bota e ardhshme. Marrëdhënia ndërmjet tyre është sikur marrëdhënia e tokës së punuar dhe frytit të saj. E lëvroni tokën, e mbjellni farën, e ujitni dhe e ruani arën derisa të piquet fryti. E pas korrjes furnizoheni me frytin e kësaj are për një vit. Normalisht, do të korrni atë që keni mbjellë. Nëse keni mbjellë grurë, do të korrni vetëm grurë. Nëse keni mbjellë gjemba, vetëm gjemba do të korrni. Nëse asgjë nuk keni mbjellë, nuk do të korrni asgjë. Të gjitha gabimet që do t'i bëni gjatë lëvrimit, mbjelljes, ujitjes do t'i shihni gjatë korrjes. Mirëpo, nëse i keni bërë të gjitha veprat me maturi dhe në mënyrë korrekte, rezultatit e të mirën e kësaj, po ashtu do ta shihni gjatë korrjes. E njëjta situatë është edhe me jetën tonë në botën e ardhshme. Kjo botë është si toka për përpunim. Njeriu është i dërguar në këtë arë për të bërë përgatitje për vete, me mundin dhe punën e zellshme të tij. I është dhënë kjo detyrë për ta kryer prej lindjes e gjer në vdekje. Çfarëdo bime që të mbjellë njeriu në këtë botë, të njëjtën do ta korrë në jetën e tij të dytë, në jetën e pas varrit, kurse prodhimi do të jetë mbështetja kryesore e jetës së tij në botën tjetër. Nëse ndokush tërë jetën kultivon fryte të mira në fushat e kësaj bote, i ujitë e i mbikëqyrë mirë, në botën e ardhshme do të gjendet në shkallën e parë dhe do t'i gjejë frytet e tij të pjekura, në kopshtin e

lulëzuar. Atje askush nuk do të kërkojë të punojë ndonjë punë të rëndë, për shkak se do të jetojë i kënaqur nga frytet e kopshtit të tij, të cilat i ka mbikëqyrë me punë të mundimshme gjatë tërë jetës në këtë botë. Kjo quhet xhennet dhe është gjendje e kënaqësisë në atë botë. Përkundër kësaj, kushdo që në këtë jetë të kësaj bote mbjell gjemba dhe kultivon bimë helmuese e të hidhura, korrje të tillë do të ketë edhe në botën e ardhshme. Nuk do të ketë rast të çlirohet nga ky mëkat dhe të kultivojë fryte të mira pasi që t'i djetë të mëparshmet. Atëherë do të jetë i detyruar të jetojë me fryte të këqija, të cilat i ka kultivuar gjatë kësaj jete. Medoemos do të duhet të flejë në krevat prej gjembave, të cilin e ka kultivuar vetë. Kjo mendohet kur flitet për humbjen dhe mossuksesin në botën e ardhshme. Sqarimin e dhënë e argumentojnë Kur'ani a.sh. dhe Hadithi. Këto dy burime kryesore të Islamit tregojnë se suksesi ose mossuksesi i njeriut në jetën pas vdekjes dhe mbarimi i tij i mirë ose i keq është rezultat i diturisë së tij dhe faktit se sa të drejta kanë qenë veprat e tij në këtë botë.

PËRSE EKZISTON DALLIMI NË PASOJAT NDËRMJET KAFIRIT DHE MUSLIMANIT?

Duke kuptuar temën e lartshpjeguar bëhet i qartë fakti se dallimi ndërmjet kafirit dhe muslimanit nuk bëhet pa shkaqe të arsyeshme. Në realitet, dallimi që tregohet në fund është rezultat i dallimit që ka ekzistuar qysh në fillim. Nëse nuk ka dallim ndërmjet diturisë dhe veprës së muslimanit dhe kafirit në këtë botë, nuk mund të ketë dallim edhe në pozitat e fundit të këtyre dy lloj njerëzish në

botën e ardhshme. Assesi nuk është e mundur që dituria dhe vepra e një personi të jetë e njëjtë me atë të kafirit e mos të ketë edhe fatin e njëjtë me atë të kafirit në botën tjetër.

QËLLIMI I KELIMES- REFORMË E DITURISË DHE VEPRËS

Tani përsëri parashtrohet pyetja: cili është qëllimi i shprehjes së kelimes? Më parë u përgjigjet se qëllimi është në dallimin e pozitës finale të kafirit dhe të muslimanit. Tash, pasi që dëgjuam sqarimin e kuptimit të pozitës finale dhe të botës së ardhshme, duhet të rishqyrtoni përgjigjet tuaja. Tash medoemos do të duhet të thoni se qëllimi i shprehjes së kelimes është përmirësimi i diturisë dhe i veprës njerëzore, ashtu që pozita finale në botën e ardhshme të jetë e mirë. Kjo kelime e mëson njeriun të kultivojë kopshtin, frytet e të cilit do t'i mbledhë në botën e ardhshme. Nëse një njeri nuk beson në kelimen, si mundet të kultivojë një kopsht të tillë dhe prej nga do të mbledhë fryte në botën tjetër? Po, nëse edhe vetëm e shpreh kelimen, e dituria e tij nuk ndryshohet, mbetet e njëjtë me atë të atij që nuk e shpreh aspak kelimen dhe veprat e tij mbeten të njëjta me veprat e kafirit, atëherë do të thoni se është e kotë të shprehet kelimeja në këtë mënyrë. Nuk ka arsye që pozita finale e personit të tillë të jetë më e mirë nga ajo e kafirit. Në fund të fundit, ai nuk i besatohet All-llahut xh.sh. me murmuritje të rastit të kelimes. Si mund të presim kopshte të lulëzuara dhe me fryte të mira në botën e ardhshme, kur as që kemi mësuar metodën e kultivimit e as që kemi kultivuar një gjë të tillë, por përkundrazi, kemi mbjellë gjemba tërë jetën? Siç kam sqaruar edhe disa herë, e kotë dhe pa rëndësi është të marrësh një aktivitet që ka të njëjtin rezultat edhe nëse e kryen edhe nëse nuk e kryen. Ato ilaçe nuk janë ilaçe nëse, kur t'i

përdorë pacienti, nuk e ndryshojnë gjendjen e tij shëndetësore. Plotësisht pa qëllim është shprehja e kelimes nga ana e muslimanit, nëse kjo nuk e bën dallimin në dituri dhe vepër me kafirin. Nëse nuk ekziston dallimi ndërmjet kafirit dhe muslimanit në këtë botë, si mund të ketë dallim ndërmjet tyre në botën e ardhshme?

ÇKA MËSON KELIMEJA TAJJIBE?

Parashtrohet pyetja: cila është ajo dituri që kelimeja e transferon tek njeriu, dhe cili është dallimi ndërmjet veprave të muslimanit dhe kafirit, pas pranimit të kësaj diturie?

1) Përrulje All-llahut xh.sh.

Çështja e parë që mësohet nga kelimeja është ajo se ju jeni robër vetëm të All-llahut xh.sh. e të askujt tjetër. Pasi që të pranoni këtë, automatikisht kuptoni se në këtë botë medoemos duhet të veproni në pëlqim me ligjet e asaj Qenieje, rob i së Cilës jeni, sepse, nëse veproni në kundërshtim me dëshirën e Tij, është njësoj sikur t'i rebelohesh Zotit xh.sh.

2) Dëgjueshmëria Pejgamberit a.s.

Pasi të mësoni këtë çështje, e dyta është besimi në Pejgamberinë e Muhammedit a.s.. Pasi të mësoni këtë, bëhet e qartë se duhet të kultivoni kopshtin në suaza të mësimit të tij (Pejgamberit a.s.). Nëse i pasoni këshillat e tij do të keni të korra të mira në botën tjetër. Mirëpo, nëse veproni

në kundërshtim me mësimin e tij, do të kultivoni vetëm gjemba në këtë botë, dhe vetëm gjemba do të korrni në botën e ardhshme.

VEPRAT MEDOEMOS DUHET TË JENË NË PAJTIM ME DITURINË

Pasi të pranojmë këtë dituri, medoemos duhet t'ia pëlqejmë edhe veprat. Nëse besoni se një ditë do të vdisni, se pas vdekjes ekziston jetë tjetër, të cilën do të duhet ta mbani vetëm me ato fryte që i keni mbjellë në këtë botë para se ta lëshoni, e pamundur është të lajthitni nga rruga e Muhammedit s.a.v.s.. Përse e punoni tokën në këtë botë? Thjesht, shi për atë se jeni të sigurt se nuk mbinë asgjë pa përpunimin e tokës. Pa përpunimin e tokës nuk ka fryte, e pa fryte, prej urie, do të vijë vdekja. Nëse nuk jeni të sigurt në këtë, dhe nëse mendoni se frytet mund të rriten pa përpunimin e tokës, ose urinë mund ta shuani pa ushqim, asnjëherë nuk do të kishte nevojë të bëni punë aq të madhe rreth përpunimit të tokës. Në këtë bazë mund ta gjykoni pozitën tuaj. Një person që deklaron në mënyrë gojore se e pranon All-llahun xh.sh. si Zot të tij, kurse Muhammedin a.s. si Pejgamber të All-llahut xh.sh., dhe që e beson jetën pas vdekjes, por veprat e tij janë në kundërshtim me mësimet Kur'anore dhe me mësimet e Sunnetit të Pejgamberit a.s., me të vërtetë ky person është me besim të dobët. Po ashtu, nëse ky është i sigurt në rezultat të dobët nëse nuk e punon tokën dhe sikur të ishte i sigurt në të njëjtën mënyrë në rezultat të dobët nëse nuk kultivon fryte për botën e ardhshme, ai kurrë nuk do të ishte i pakujdesshëm. Askush me vetëdije nuk mbjell gjemba për vete. Këtë gjë e bën vetëm ai person që nuk beson se atë që e mbjell edhe do ta korrë dhe që nuk beson se këto gjemba do të shkaktojnë fatkeqësinë e tij.

Askush nuk e kapë gacën me dorë, sepse është i vetëdijshëm se e djeg. Mirëpo, fëmija e futë dorën në zjarr, sepse nuk është i vetëdijshëm për pasojat e kësaj vepre.

EBU'L-A'LA EL-MEWDUDI (1903-1979),

njëri nga udhëheqësit dhe arkitektët më të mëdhenj të përtëritjes bashkëkohore Islame, është mendimtari dhe shkrimtari më i shquar Islam i kohës sonë. Ai tërë jetën ia kushtoi shpjegimit të mesazhit dhe të domethënies së Islamit, duke i ftuar individët që ta ripërtërijnë zotimin ndaj Krijuesit të tyre dhe duke organizuar një lëvizje për vendosjen e tërësishme të Islamit. Në këto përpjekje, ai përjetoj mundime nga më të ndryshmet. Prej v.1948 deri në v.1967, në katër raste, është burgosur dhe nëpër burgjet e Pakistanit ka kaluar plot pesë vjet. Më 1953, për shkak të shkruarjes së një broshure “kryengritëse”, nga ana e Gjyqit Ushtarak është dënuar me vdekje. Ky vendim, më vonë, u zëvendësua me burgim të përjetshëm. Më 1941 themeloi “*Xbemaati Islamijjennë*”, që është njëra nga lëvizjet më prominente Islame të ditëve tona, dhe njëkohësisht u zgjodh Emir i saj.

Ka shkruar më tepër se njëqind vepra dhe punime për Islamin, të cilat janë përkthyer në afro dyzet gjuhë. Nga veprat e shumta, këtu do ta cekim kryeveprën e tij - Tefsirin “*Tefhimu'l Kur'an*”.